



SHOQATA KOMBËTARE E PUNONJËSVE SOCIALË

Raport mbi projektin

“Ngritja e kapaciteteve të
këshilluesve shkollorë mbi Dhunën
me Bazë Gjinore”

Tiranë, 2014



Titulli:

Raport mbi projektin “*Ngritja e kapaciteteve të këshilluesve shkollorë mbi Dhunën me Bazë Gjinore*”

Raporti i përgatitur nga:

**Eliona Bimbashi
Marsela Allmuça**

Grupi i ekspertëve në projekt:

**Fatlinda Berisha
Ensuida Hoxha
Etleva Sheshi
Daniela Kalaja**

Design:

Xhina Çaçi

“Ky Raport, është mundësuar me mbështetjen teknike dhe financiare të UNICEF, në kuadër të projektit “*Ngritja e kapaciteteve të këshilluesve shkollorë mbi Dhunën me Bazë Gjinore*” zbatuar me fondet e Qeverisë Suedeze. Përmbajta e tij është përgjegjësia e vetme e Shoqatës Kombëtare të Punonjësve Socialë, dhe opinioni i shprehur në të jo domosdoshmërisht është opinion i UNICEF”.

PËRMBAJTJA

| | |
|--|-----------|
| Hyrje | 6 |
| 1. Metodologjia e Raportit të Projektit. | 8 |
| 2. Vlerësimi i nevojave të këshillueve shkollorë mbi DHBGJ..... | 11 |
| 3. Aktivitetet e projektit “Ngritja e kapaciteve të këshilluesve shkollorë mbi DHBGJ” dhe rezultatet e arritura. | 27 |
| 4. Temat e trajnimit dhe reagimet e marra nga pjesmarrësit në trajnime. | 35 |
| 5. Rekomandime se si mund te organizohen aktivitetet trajnuese në vazhdimësi. | 44 |
| 6. Një analizë mbi situatën aktuale të Shërbimit Psiko-Social në Shkolla..... | 47 |
| Referenca | 64 |

LISTA E SHKURTIMEVE

| | |
|----------------|---|
| MAS | Ministria e Arsimit dhe Sporteve |
| SHKPS | Shoqata Kombëtare e Punonjësve Socialë |
| SHSSH | Shërbimi Social Shtetëror |
| DAR | Drejtoria Arsimore Rajonale |
| ZA | Zyrë Arsimore |
| SHPSSH | Shërbimi Psiko-social në Shkolla |
| PSHPSSH | Punonjësit e Shërbimit Psiko-social në Shkolla |
| KSH | Këshillues Shkollorë |
| NJMF | Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve |
| MR | Menaxhimi i Rastit |
| PI | Plane Individuale |
| DHBGJ | Dhuna me Bazë Gjinore |

Falenderime

Ky raport u përgatit nga Shoqata Kombëtare e Punonjësve Socialë (SHKPS) dhe nga një skuadër e dedikuar ekspertësh në fushën e DHBGJ dhe shërbimit psiko-social në shkolla.

Veçanërisht falenderojmë UNICEF për mbështetjen financiare në implementimin e këtij projekti dy vjeçar me një rëndësi të veçantë në fuqizimin e shërbimit psiko-social në shkolla si edhe perfaqesuesen e tij, Znj. Alketa Zazo për konsulencën e vazhdueshme të dhënë gjatë gjithë implementimit të projektit.

Gjithashtu, SHKPS falenderon për gadishmërinë dhe bashkëpunimin e frytshëm gjatë procesit të implementimit të projektit, përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, përfaqësuesit e Drejtorisë Arsimore Rajonale të qytetit të Tiranës, Drejtorisë Arsimore Rajonale të qarkut Tiranë, Drejtorisë Arsimore rajonale të qarkut Durrës, Zyrën Arsimore Kavajë dhe Zyrën Arsimore Kamëz.

Një falenderim i veçantë shkon për të gjithë ofruesit e shërbimit psiko-social në shkollat e Qarkut të Tiranës dhe Durrësit, për interesin dhe kontributin e dhënë në përmbushjen e objektivave të projektit dhe në suksesin e tij.

HYRJE

Shoqata Kombëtare e Punonjësve Socialë në Shqipëri me mbështetjen financiare të UNICEF, implementoi gjatë periudhës 2013-2014 projektin “*Ngritja e kapaciteteve të këshilluesve shkollorë mbi DHBGJ*”, i cili në fokus të tij kishte ofrimin e një trajtimi më cilësor dhe efektiv të dhunës me bazë gjinore midis adoleshenteve, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të këshilluesve shkollorë (KSH)¹ në identifikimin dhe adresimin e çështjeve të DHBGJ midis adoleshentëve.

Objektivat kryesore të projektit ishin (i) vlerësimi i nevojave për trajnim të këshilluesve shkollorë mbi çështjet e DHBGJ, trajtimin e adoleshentëve dhe familjarëve të tyre; (ii) zhvillimi i një moduli trajnimi mbi njohuritë në fushën e DHBGJ, duke adresuar çështjet dhe trajtimin e viktimeve/rasteve nga këshilluesit shkollorë; (iii) rritja e nivelit të ndërgjegjësimit, njohurive dhe aftësive të këshilluesve shkollorë në identifikim, raportimin dhe trajnimin e të mbijetuarve të DHBGJ midis adoleshentëve; si dhe (iv) rritja e nivelit të informacionit të adoleshentëve në shkolla mbi çështjet e DHBGJ nëpërmjet materjaleve informuese.

Për përmbushjen e objektivave të përgjithëshme të kësaj nisme, u organizuan një llojshmëri aktiviteteve të tilla si:

1. Vlerësimi i nevojave për trajnim të këshilluesve shkollorë;
2. Përgatitja e një moduli trajnimit;
3. Organizimi i trajnimit të trajnerëve (ToT);
4. Organizimi i sesioneve të trajnimeve me këshilluesit shkollorë;
5. Organizimi i trajnimeve në vendin e punës “on the spot” me KSH;
6. Publikimi i fletpalosjeve informuese për adoleshentët;

¹ Termi Këshillues Shkollorë i referohet punonjësve të shërbimit psiko-social në shkolla (SHPSSH) sipas UNICEF

7. Përgatitja dhe publikimi i Manualit të Referencës mbi DHBGJ dhe i Raportit të projektit;
8. Takim përmbyllës me palët e interesuara.

Ky projekt u zbatua në partneritet të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Drejtoritë Arsimore Rajonale Tiranë, Drejtorinë Arsimore të Qarkut Tiranë, Drejtorinë Arsimore Rajonale Durrës, Zyrën Arsimore Kavajë dhe Zyrën Arsimore Kamëz.

Në këtë raport janë pasqyruar aktivitetet dhe rezultatet e arritura gjatë zbatimit të projektit, duke u fokusuar në strategjitë dhe qasjet kryesore të përdorura. Gjithashtu, raporti analizon boshllëqet, nevojat dhe mundësitë për trajnime në vazhdimësi, me synimin që kjo eksperiencë të shërbejë si një rast për aktivitetet të vazhdueshme në të ardhmen në ndërtimin e kapaciteteve dhe rritjen e cilësisë së shërbimit psiko-social në shkollat tona. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i raportit është dhe ofrimi i ideve të reja mbi mënyra alternative të fuqizimit të këshilluesve shkollorë dhe shërbimit në përgjithësi, të ndryshme nga sesionet tradicionale të trajnimit dhe të përshtatura me nevojat e identifikuara.

KAPITULLI 1

METODOLOGJIA E RAPORTIT TË PROJEKTIT

Për përgatitjen e raportit mbi projektin “*Ngritja e kapaciteteve të këshilluesve shkollorë mbi DHBGJ*” janë përdorur metodat e mëposhtme të vlerësimit si: 1. rishikim i dokumentave zyrtare dhe legjislacionit mbi SHPSSH, 2. pyetësorë vlerësues, 3. fokus grupe me ofrueset e shërbimit psiko-social në shkolla dhe 3. intervista gjysëm të strukturuar me persona të informuar dhe të përfshirë në projekt.

1.1 Rishikim i dokumentave zyrtare dhe legjislacionit mbi SHPSSH

Për të paraqitur një pamje sa më të plotë të situatës së shërbimit psiko-social në vendin tonë në këtë raport, u rishikuan një sërë dokumentash zyrtarë që lidhen me SHPSSH, si kuadri ligjor mbi arsimin parauniversitar dhe urdhërat e veçantë mbi shërbimin psiko-social në shkolla, raporte studimore, statistika, manuale udhëzuese, etj.

1.2 Pyetësi vlerësues

Në përfundim të çdo sesioni trajnimi me këshilluesit e shkollave të targetuara janë administruar 83 pyetësorë vlerësimi. Nëpërmjet këtyre pyetësorëve u morën të dhëna mbi cilësinë e informacionit të

marrë në trajnime, mbi procesin, përmbajtjen dhe metodologjinë e trajnimit si edhe nivelin e përdorimit të këtij informacionit në punën e përditshme nga përfituesit.

1.3 Fokus grupet me ofrueset e shërbimit psiko-social në shkolla

Një metodë tjetër e përdorur në këtë vlerësim ishte organizimi i 3 fokus grupeve me këshilluesit shkollorë në Tiranë, Durrës dhe Kavajë, me qëllim mbledhjen e një informacioni më të hollësishëm mbi trajnimet e përfituara, efektivitetin e përdorimit të njohurive dhe modeleve praktike të punës të marra nga trajnimet e projektit “*Ngritja e kapaciteteve të këshilluesve shkollorë mbi DHBGJ*” në trajtimin dhe menaxhimin e rasteve specifike të DHBGJ në shkolla, mundësi dhe sfida në përdorimin e tyre në punën e përditshme, si edhe ide mbi nevojën për trajnime të tjera. Në fokus grupe u përfshinë punonjës socialë dhe psikologë me eksperiencë të gjatë në SHPSSH, si edhe KSH të punësuar rishtazi në këtë shërbim.

Diskutimi në fokus grupet e zhvilluara u përqendruan në tematikat kyçe si:

- *Mundësitë dhe vështirësitë e deritanishme të KSH në vënien në përdorim të njohurive të marra nga trajnime të mëparshme;*
- *Mundësitë dhe vështirësitë e mundshme në vënien në përdorim të njohurive dhe modeleve praktike të përfituara nga aktivitetet trajnuese të projektit, bazuar në eksperiencat e mëparshme të KSH me rastet e DHBGJ;*
- *Probleme të bashkëpunimit me stafin mësimor dhe administrativ të shkollës dhe ndikimi i tij në përdorimin e informacioneve të marra;*
- *Puna konkrete me rastet problematike të DHBGJ dhe vështirësitë e hasura që lidhen me organizimin dhe menaxhimin e institucioneve arsimore apo institucionet e tjera përgjegjëse;*
- *Niveli i njohjes së shërbimeve për referim dhe menaxhim efektiv të rasteve të DHBGJ dhe bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse;*
- *Probleme të bashkëpunimit me familjaret dhe sfidat e mundshme;*

- *Nevoja për përmirësimin dhe rritjen e vazhdueshme profesionale të KSH;*
- *Gjenerimi i ideve mbi tematika me interes dhe metoda të reja alternative për ngritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve profesionale të KSH / punonjësve të SHPSSH.*

1.4 Intervistat gjysëm të strukturuar me personat kyç

Në kuadër të përgatitjes së raportit të projektit u realizuan edhe 5 intervista gjysëm të strukturuar me persona kyç, ndër të cilat: një me personin përgjegjës për shërbimin psiko-social në MAS, dy me drejtuesit e DAR Tirana & Durrësi dhe dy intervista me drejtues shkollash. Nëpërmjet tyre u synua marrja e një informacioni më specifik mbi çështje dhe problematika organizative dhe institucionale që ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën dhe mundësinë e përdorimit të modeleve praktike të DHBGJ, të ofruara gjatë trajnimeve me KSH.

KAPITULLI 2

VLERËSIMI I NEVOJAVE TË KËSHILLUESVE SHKOLLORË MBI DHBGJ

Komponenti i parë projektit ishte “*Vlerësimi i kapaciteteve të këshilluesve shkollorë mbi dhunën me bazë gjinorë*”, i cili shërbeu si një bazë për të projektuar dhe zhvilluar aktivitetet në vazhdim me qëllim trajnimin KSH në punën me rastet e DHBGJ si dhe fuqizimin e SHPSSH në qarqet e targetuara. Proçesi i vlerësimit të nevojave kaloi në disa etapa si: (1) krijimin e grupit të punës, (2) nënshkrimin e marveshjeve të bashkëpunimit, (3) mbledhjen e të dhënave nëpërmjet pyetësorëve dhe fokus grupeve me këshilluesit shkollorë dhe (4) analizimin e të dhënave dhe përgatitjen e raportit final mbi vlerësimin e nevojave.

Pjesë e këtij studimi ishin 68 specialistë të shërbimit psiko-social në shkolla, të cilët aktualisht janë të punësuar pranë zyrës së shërbimit psiko-social në shkollat e qarkut të Tiranës dhe Durrësit. Pjesa më e madhe e subjekteve ishin nga qarku i Tiranës (79%) dhe 21% nga qarku i Durrësit.

Mosha e subjekteve të përfshirë në studim varion nga 25-37 vjeç, ku pjesa më e madhe janë në grupmoshën 30-33 vjeç. Shkollat e përfshira në studim ishin kryesisht urbane, në 85% të rasteve, gjë që përkon dhe me shpërndarjen aktuale të shërbimit.²

² Vlerësimi i nevojave të këshilluesve shkollorë mbi DHBGJ. SHKPS, Tiranë, 2013

2.1 METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË NEVOJAVE

Për të realizuar studimin “*Vlerësimi i kapaciteteve të këshilluesve shkollorë mbi dhunën me bazë gjinorë*” janë përdorur metoda mikse të kërkimit, sasiore dhe cilësore të tilla si: rishikimi i literaturës egzistuese, pyetësorë dhe fokus grupe me ofruesit e shërbimit, duke iu referuar standarteve bashkëkohore të kërkimit shkencor. Qëllimi i përdorimit të metodave mikse të kërkimit është i lidhur me qëllimin e vlersimit, për të eksploruar situatën, identifikuar problemet dhe vështirësitë me të cilat përballlet ky shërbim në punën me rastet e DHBGJ.

Qëllimi i studimit ishte vlerësimi i nevojave të këshilluesve shkollorë (KSH), mbi dhunën me bazë gjinore (DHBGJ) në shkollat e qarkut të Tiranës dhe të Durrësit për adresimin e tyre në trajnimet e parashikuara në projekt.

2.1.1 Popullata e studimit

Popullata e këtij studimi ishin të gjithë ofruesit e shërbimit psiko-social në shkollat e Tiranës dhe të Durrësit (punonjës social, psikologë, ne disa raste edhe mësues). Kriteri i vetëm për përfshirje ishte që punonjësi të ishte i emëruar si ofrues i shërbimit psiko-social. Duke qenë që një këshillues i këtij shërbimi ofron shërbim në më shumë se një shkollë, u mbajtën shënime shkollat përkatëse për secilin punonjës, me qëllim mospërfshirjen më shumë se një herë të një subjekti. Në tërësi numri i këshilluesve shkollorë të pyetur përmes pyetësorëve ishte 68 subjekte. Ndërkohë që numri i pjesëmarrësve në fokus grupe ishte 32.

2.1.2 Instrumentat e përdorura

Për realizimin e vlerësimit të nevojave të Këshilluesve Shkollorë u përdorën instrumentat e kërkimit, si pyetësori gjysëm i strukturuar dhe fokus grupet me KSH që ofrojnë aktualisht SHPSSH.

2.1.3 Pyetëtori gjysëm i strukturuar

Instrumenti i parë i përdorur për mbledhjen e të dhënave ishte pyetëtori gjysëm i strukturuar. Kohëzgjatja e një pyetëtori ishte rreth 25-30 minuta dhe u realizua në mjediset e shkollave përkatëse. Pyetëtori përmbante 62 pyetje, të cilat ishin organizuar sipas sesioneve të mëposhtme:

Sesioni i parë synonte të merrte informacion të përgjithshëm mbi subjektet e përfshira në vlerësim, të tilla si arsimimi i tyre profesional, koha e ushtrimit të profesionit, numri i shkollave dhe nxënësve që mbulon secili, si dhe trajnimet e marra nga ai/ajo gjatë eksperiencës si KSH.

Sesioni i dytë u përqendrua në identifikimin e strategjive dhe mënyrave që këshilluesi shkollor përdorin në punën individuale me nxënësit dhe mbi perceptimin e tyre mbi njohjen e rolit të KSH nga aktorët e tjerë të shkollës.

Sesioni i tretë synoi të merrte informacion mbi njohuritë e përgjithshme të këshilluesit shkollorë mbi DHBGJ, përmes disa dimensioneve të dhunës, format e dhunës (si dhuna psikologjike, fizike, seksuale), modele pune të përdorura për identifikimin e DHBGJ, elementë dallues të sjelljes që reflekton abuzimin. Referimi i rasteve të DHBGJ dhe përvoja e tyre në këtë praktikë ishte një tjetër drejtim ku u fokusua pyetëtori.

Sesioni i katërt synoi të eksploronte njohuritë që kanë KSH mbi format e identifikimit të rasteve (duke përfshirë ato që përdoren aktualisht në praktikë si dhe ato të cilat teorikisht duhet të përdorë një këshillues shkollor).

Sesioni i pestë u përqendrua në marrjen e informacionit lidhur me bashkëpunimin e këshilluesit shkollorë me mësuesit dhe stafin administrativ të shkollës, format e këtij bashkëpunimi, njohjen e rolit të tij nga mësuesit dhe perceptimin që vetë këshilluesi kishte mbi bashkëpunimin me mësuesit në identifikimin e rasteve të DHBGJ. Në këtë sesion u mbledh informacion i hollësishëm edhe për nevojat specifike për trajnim të vetë këshilluesve shkollorë dhe stafit mësimor.

2.1.4 Fokus grupet

Nëpërmjet fokus grupeve u eksploruan më në thellësi nevojat e këshilluesve duke i vendosur ata në bashkëveprim me njëri tjetrin me qëllim krijimin e dinamikave brënda grupeve. Për këtë vlerësim u realizuan 5 fokus grupe. Kohëzgjatja e tyre ishte nga 90 deri në 120 minuta dhe përbëheshin mesatarisht nga 7 anëtarë, të zhvilluara si më poshtë:

- *2 fokus grupe me këshilluesit shkollorë të qytetit të Tiranës;*
- *1 fokus grup me këshilluesit shkollorë të Qarkut e Tiranës (komunat);*
- *1 fokus grup me këshilluesit shkollorë në Kavajë dhe;*
- *1 fokus grup me këshilluesit shkollorë në Durrës.*

Fokus grupet eksploruan gjithashtu më në thellësi mbi problematikat e këshilluesve shkollorë, vështirësitë në punën me rastet e dhunës me bazë gjinore, sistemin e referimit dhe njëkohësisht modalitetet e identifikimit të rasteve apo trajtimit të tyre.

Diskutimi në fokus grupe u përqendruan në disa tematika kyçe si:


- *Niveli i njohjes së shërbimeve për referim dhe për bashkëpunim në rastet e DHBGJ;*
- *Probleme të bashkëpunimit me stafin mësimor dhe administrativ të shkollës;*
- *Identifikimi dhe trajtimi i rasteve të DHBGJ;*
- *Bashkëpunimi me familjarët;*
- *Puna me grupet dhe individin;*
- *Bashkëpunimi me policinë;*
- *Bashkëpunimi me bordin e prindërve;*
- *Nevoja për trajnim në lidhje me DHBGJ.*

2.2 DISA NGA REZULTATET E VLERËSIMIT

Në këtë sesion janë paraqitur vetëm një pjesë e rezultateve të studimit që lidhen më specifikisht me tipologjinë e rasteve të DHBGJ të hasura në institucionet arsimore, njohuritë dhe praktikat e përdorura aktualisht me rastet e DHBGJ, si dhe nevojat e KSH për trajnime.³

⇒ Përballja e KSH me rastet e DHBGJ, frekuenca dhe format

Dhuna me bazë gjinore është një fenomen gjerësisht i hasur në shkollat e Tiranës dhe Durrësit. Sipas KSH të përfshirë në vlersim, raportohet se rastet e DHBGJ ekzistojnë dhe janë të formave të ndryshme. Këto episode fillojnë me DHBGJ në mjedisin e shkollës ndërmjet bashkëmoshatarëve, dhunën në mjedisin familjar, dhunën në mardhëniet dashurore dhe shfaqen në formën e abuzimit seksual, psikologjik, verbal dhe fizik.




Grafiku 1. Përballja me rastet e DHBGJ

Nga personat e pyetur, 72% e KSH raportojnë se janë hasur me akte të DHBGJ, gjatë punës së tyre në shkolla, ndërkohë që pjesa tjetër nuk kishin hasur asnjëherë raste të tilla (Grafiku 1). Kjo

³ SHKPS, 2013, “Vlerësimi i kapaciteteve të këshilluesve shkollorë mbi dhunën me bazë gjinorë”.

tregon për një prezencë domethënëse të këtij fenomeni në shkollat e përfshira në studim dhe si rezultat, nevojën e adresimit të këtij fenomeni me përgjigje efektive nga institucionet shkollore si dhe ofruesit e SHPSSH.

Forma më e zakonshme e DHBGJ me të cilën KSH ishin hasur disa herë (39%) ose shumë shpesh (10%) ishin aktet fizike të saj (Grafiku 2). Vetëm 2% e subjekteve të pyetur ishin hasur shpesh me raste të dhunës psikologjike dhe 6% e tyre ishin hasur disa herë me të.



Grafiku 2. Denduria e përballjes me akte specifike të DHBGJ

Rastet më të shpeshta të DHBGJ janë ato të djemve ndaj vajzave, kryesisht dhunë verbale, në mjediset e shkollës dhe jashtë saj. “Ky është një problem që ne e hasim gjatë punës tonë” (FG KSH Tiranë). Në shkollat e qytetit të Kavajës këshilluesit shkollorë theksojnë se janë hasur shpesh me raste të dhunimit të fëmijëve në familje.

“Fëmija dhunohej sistematikisht pasi nëna ishte në depresion dhe e çuam në Gjykatë ku iu hoq edhe kujdestaria e fëmijës” (FG KSH Kavajë).


Ka një dallim në tipologjinë e DHBGJ në shkollat e zonave rurale, ku disa KSH si në qarkun e Tiranës dhe atë të Durrësit shprehen se frika nga paragjykimi i shoqërisë konservatore ka penguar dhe kufizuar familjet në praninë dhe denoncimin e dhunës.

“Ata kanë një nivel të ulët ndërgjegjësimit mbi dhunën me bazë gjinore. Madje edhe dhuna psikologjike që ushtrojnë djemtë ndaj vajzave shihet si sjellje normale.” (FG KSH Durrës)

Rastet më problematike janë identifikuar në shkollat e Bashkisë Kavajë, sidomos ato të abuzimit seksual, inçestit dhe me mundësi potenciale për trafikim. Sipas KSH, në këto raste janë vënë në dijeni drejtuesit e shkollës apo përfaqësuesit e ZA në Kavajë, si dhe janë referuar në qendra të specializuara.

⇒ **Metoda të identifikimit, diagnostikimit dhe trajtimit të rasteve të DHBGJ**

Këshilluesit shkollorë gjatë vlerësimit shprehen se janë të aftë të identifikojnë rastet e DHBGJ, por nga ana tjetër vihet re se ata nuk përdorin metoda apo instrumenta të specializuara për të identifikuar këto raste.



Grafiku 3. Forma të identifikimit të rasteve

(*) *vlerat janë raportuar në njësi, ku një subjekt raporton njëkohësisht përdorim të më shumë se një mënyre për të identifikuar rastet problematike.*


Mënyra më e zakonshme për sinjalizimin mbi këto raste është ai i referimit nga mësuesit (66 raste), ndërkohë që në 56 raste të tjera raportohet se këshilluesi kontaktohet nga vetë nxënësit të cilët mund të kenë nevojë për ndihmë dhe në 55 raste ata raportojnë se i identifikojnë vetë rastet problematike. Pra, çfarë vihet re është se spektri i metodave në përdorim nga KSH për të identifikuar rastet e DHBGJ është i kufizuar vërtet në sinjalizime, referime apo vëzhgime individuale dhe mungojnë metodat alternative aktive të identifikimit të rasteve nëpërmjet përdorimit të instrumentave specifikë të standartizuar apo nëpërmjet aktiviteteve në grupe.⁴

Gjatë diskutimeve në FG u evidentua si mjaft i rëndësishëm roli i bashkëmoshatarëve në identifikimin dhe referimin e rasteve të DHBGJ. Ekziston një dallim midis shkollave të mesme ku nxënësit janë më të hapur dhe preferojnë të shkojnë vetë tek këshilluesi shkollorë, dhe tek ata të ciklin 9-vjeçar ku predominon roli i mësuesit në referimin e tyre, duke konsideruar dhe faktin se në këtë mënyrë lehtësohet dhe puna e tyre.

Sipas tyre, këto raste të DHBGJ identifikohen edhe nëpërmjet vëzhgimit të sjelljeve të vetë nxënësve të dhunuar, pasi ata shfaqen të tërhequr, mbyllen në vetvete, distancohen nga bashkëmoshatarët, bien nga mësimet, apo në rastet më ekstreme, shfaqin shenja fizike. Përdorimi i testeve/pyetësorëve për vlerësimin paraprak të nxënësve me nevojave të veçanta për shërbim psiko-social që aplikohet në disa shkolla, kryesisht në qytetin e Tiranës çdo fillim viti, ndihmojnë edhe në identifikimin e rasteve të DHBGJ.

Lidhur me diagnostikimin e rasteve të DHBGJ duket se ka diferenca në larminë e metodave të përdorura.


⁴ Po aty



Grafiku 4. Metoda të diagnostikimit të rasteve të prekura nga DHBGJ.

Nga tabela e mësipërme rezulton një përdorim i disa metodave për të diagnostikuar rastet e DHBGJ të identifikuar paraprakisht, ku dominon metoda e vëzhgimit në vazhdimësi të rastit dhe intervistimi individual i nxënësit. Në diskutimet në fokus grupe, këshilluesit shkollorë raportojnë gjithësesi nevojën për tu trajtuar lidhur me teknikat specifike për identifikimin, diagnostikimin dhe trajtimin e rasteve të DHBGJ si dhe nevojën e hartimit dhe përdorimit të një protokollit për trajtimin e standartizuar të tyre.

Midis **metodave të përdorura për të trajtuar/referuar/adresuar rastet e DHBGJ** ajo që përdoret më tepër nga KSH rezulton të jetë biseda individuale me nxënësit, por nuk mungojnë dhe kontaktet me mësuesit dhe familjen. Ndërkohë vetëm në 28 raste (afërsisht 1/3 e rasteve) KSH raportojnë për ndërtimin e një programi individual ndihme për trajtimin e DHBGJ dhe vetëm në 12 raste raportojnë për referim në shërbimet e specializuara për trajtimin e DHBGJ.




Grafiku 5. Metodat e trajtimit/referimit/adresimit të problemit të DHBGJ

(*) vlerat janë raportuar në njësi, ku një subjekt raporton njëkohësisht për më shumë se një përgjigje.


Nga ana tjetër, të dhënat nga FG argumentojnë se mungesa e njohurive të mjaftueshme mbi ndërtimin e programeve individuale dhe mungesa e formateve të gatshme të standartizuara kushtëzon përdorimin e kufizuar të tyre në trajtimin e rasteve si edhe referimin adekuat në shërbime të specializuara. KSH në mënyrë eksplicite shfaqin nevojën për trajnime specifike mbi metoda dhe shprehi të punës së tyre në këtë drejtim. Këto shprehi konsistojnë në teknika specifike për identifikimin e rasteve të DHBGJ, njohjen me teste psikometrike për DHBGJ, apo edhe me shprehi dhe teknika të lehtësimit/trajtimit/adresimit të këtij problemi.

Gjithashtu, KSH raportojnë se kanë **njohuri të kufizuara mbi agjencitë/shërbimet** për trajtimin profesional të rasteve të DHBGJ.



Grafiku 6. Njohja e shërbimeve që adresojnë DHBGJ

Gjysma e KSH (50%) shprehen se nuk kanë njohuri mbi agjensi konkrete që trajtojnë këto raste në territorin e tyre.⁵ Në FG argumentohet se mungesa e një informacioni zyrtar mbi shërbime të liçensuara apo të besueshme dhe të kontrolluara nga autoritetet e bën të vështirë procesin e referimit dhe adresimit të rasteve. Edhe në rastet kur këto shërbime ekzistojnë, përvoja e tyre jo pozitive, nxit izolimin dhe mostrajtimin adekuat për këto raste.



Grafiku 7. Përvoja me referimin e rasteve të DHBGJ

⁵ Po aty

Një element i përmendur nga këshilluesit shkollorë, në lidhje me referimin e rasteve, është edhe mungesa e personave të specializuar në agjencitë përkatëse, të cilat nuk janë parë si partner të besueshëm për rastet e identifikuar. Përvoja jo pozitive, shihet si një faktor që ka ndikuar në mos përdorimin e sistemit të referimit të rasteve të identifikuar si viktime të DHBGJ.

“Kemi patur eksperiencë jo pozitive me referimet, pasi kemi vënë re se rasti nuk ka marrë trajtimin e duhur.” Këshilluesit shkollorë përmendën linjën Alo 116, - *“edhe në këtë rast ofrohet vetëm supervizim nëpërmjet telefonit”*.

Problem mbetet edhe mosnjohja e shërbimeve për referimin e rasteve, gjë për të cilën thuajse të gjithë këshilluesit bien dakord. Njëri prej pjesëmarrësve në fokus grupe shprehet:

“Mungesa e një adresari me shërbime të miratuara nga institucionet përgjegjëse sjell shpesh referimin e organizatave që janë “fantazma” dhe jo të miratuara, gjë që e vështirëson apo e bën të pamundur referimin e rasteve tek shërbimet përkatëse të specializuara. Vetëm me qendrat komunitare të shëndetit mendor kemi një përvojë disi më pozitive, sepse ato ofrojnë trajtim dhe shërbim mjaft të mirë për fëmijët me nevoja të veçanta, por sërish kjo nuk lidhet me fushën e DHBGJ.”(FG KSH Tiranë)

Rast specifik përbën ai i KSH në qytetin e Kavajës, në të cilin rezulton se ka një mungesë totale të shërbimeve, jo vetëm për rastet e DHBGJ, por për të gjithë problematikat me të cilat hasen nxënësit:


“Ne mund të adresojmë vetëm në policinë e qytetit, për situata emergjente. Sa i takon trajtimin më të specializuar na duhet ti çojmë rastet në Tiranë, por shpeshherë familjen nuk kanë mundësi ekonomike për të përballuar shpenzimet, që kërkojnë për ndjekjen e rastit.” (FG KSH Kavajë)

Mungesa tërësore e shërbimeve rrit ngarkesën e këshilluesve shkollorë dhe ul ndjeshëm cilësinë me të cilën ky shërbim ofrohet, duke marrë në konsideratë edhe faktin se një këshillues mbulon një numër të madh nxënësish (1 KSH mbulon 2400-3500 nxënës) dhe problematikash, si edhe fakti që

i njëjti KSH mbulon njëkohësisht nxënës të institucioneve arsimore të disa niveleve të edukimit). I vetmi rast i identifikuar si i suksesshëm është ai i referimit nga dy këshillues shkollorë në shkollat e Durrësit, të cilët kanë referuar për ndihmë sociale tek SHSSH, apo tek NJMF-të në Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe raportojnë për bashkëpunim të suksesshëm dhe pozitiv:

“Në të vërtetë shërbimet që ofrojnë shërbime për të rinjtë dhe adoleshentët mungojnë, ka vetë për fëmijët në qytetin tonë.” (FG KSH Durrës)

Përmbledhtazi, mund të themi se shërbimet të cilat ofrojnë trajtim të specializuar mbi DHBGJ në qytetin e Tiranës dhe të Durrësit, janë të pakta dhe përgjithësisht nuk njihen nga këshilluesit shkollorë. Edhe në rastet kur ata i kanë përdorur shërbimet për të adresuar raste, ato nuk kanë patur lidhje me DHBGJ.



Grafiku 8. Arsyet pse nuk janë raportuar rastet e DHBGJ (kur këshillues është hasur me to)

() vlerat janë raportuar në njësi, ku një subjekt raporton njëkohësisht për më shumë se një përgjigje.*

⇒ Nevoja për trajnim të specializuar mbi DHBGJ

Bazuar në të dhënat e marra nga pyetësorët dhe FG rezulton që pjesa më e madhe e subjekteve të përfshirë në studim shprehen se kanë nevojë për trajnime mbi DHBGJ (92%), në çështjet e praqitura më poshtë:

- Njohuri të thelluara mbi dhunën në familje, specifika të DHBGJ në kontekstin familjar;
- Metoda e teknika specifike të identifikimit të rastit dhe shenjave dalluese të dhunës, veçanërisht asaj seksuale;
- Metoda specifike të trajtimit të rasteve (ndërtimi i një plani ndërhyrje për trajtimin e rastit, trajtimi shumëplanësh: kombinimi i familjes, mësuesit dhe bashkëmohatarëve në trajtimin e rasteve);
- Informacionin mbi sistemin e referimit, agjencitë specifike përgjegjëse që trajtojnë rastet e DHBGJ dhe kuadrin ligjor përkatës;
- Metoda të punës me grupet e fëmijëve dhe adoleshentëve për ndërgjegjësim dhe parandalim;
- Specifikat e DHBGJ tek fëmijët me nevoja të veçanta.

2.3 KONKLUZIONE TË VLERËSIMIT

Duket se DHBGJ është një fenomen i hasur në shkollat e Tiranës dhe Durrësit, gjë që e bën të domosdoshme njohjen e KSH me teknikat e identifikimit dhe trajtimit/adresimit/referimit të rasteve. Rastet e DHBGJ ekzistojnë dhe janë të formave të ndryshme. Këto episode fillojnë me DHBGJ në mjedisin e shkollës mes bashkëmohatarëve, dhunën në mjedisin familjar, dhunën mes të dashurve, abuzimin seksual, psikologjik, verbal dhe fizik.

Këshilluesit janë të aftë të identifikojnë raste të DHBGJ, pavarësisht se nuk përdorin metoda të specializuar në këtë proces. Përdorimi i disa metodave për identifikimin e rasteve të DHBGJ apo të trajtimit të tyre, përbën një qasje efektive, por sidoqoftë vihet re se mungon një protokoll për trajtimin e unifikuar të rasteve të tilla. Të dhënat e mbledhura tregojnë se këshilluesit shkollorë kanë nevojë për t'u trajnuar me teknika specifike për trajtimin e rasteve të DHBGJ, dhe sidomos rasteve të abuzimit seksual.

Lidhur me llojin e ndërhyrjeve që KSH praktikojnë më shpesh në eksperiencën e tyre, puna e tyre

është e orientuar në takimet ndërgjegjësuese/sensibilizuese në grup për çështje të ndryshme sociale në interes të nxënësve, por sidoqoftë të gjithë KSH raportojnë për ndjekje individuale të rasteve, apo këshillim individual, gjë e cila bëhet mjaft sfiduese në një situatë kur mungon koha dhe mjedisi i përshtatshëm për ndjekjen e rasteve. Mungojnë protokolle të punës për tu ndjekur në çështje dhe raste specifike, siç janë dhe rastet e DHBGJ. Përgjithësisht metodat që përdoren rezultojnë të jenë sporadike dhe jo të unifikuara.

Këshilluesit shkollorë kanë njohuri të kufizuara mbi agjencitë/shërbimet për trajtimin profesional të rasteve të DHBGJ. Edhe në rastet kur këto shërbime ekzistojnë, përvoja e tyre jo pozitive, nxit izolimin dhe mostrajtimin adekuat për këto raste. Mungesa apo pamjaftueshmëria e agjencive të referimit si shërbime të liçensuara apo të besueshme, e cila kontrollohet nga autoritet shtetërore e bën të vështirë procesin e referimit dhe adresimit të rasteve. Bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe lokale përgjegjëse jo gjithmonë është efektiv dhe i vazhdueshëm.

Gjithashtu, për të fuqizuar rolin e KSH në shkollë nevojitet një bashkëpunim më i mirë me drejtuesit e institucioneve arsimore, stafet mësimore, prindërit dhe komuniteti. Ky bashkëpunim ekziston, por shpesh me probleme të tilla si konfuzioni i roleve, mosnjohja e rolit të këshilluesit shkollorë nga mësuesit, stafi mësimor dhe prindërit, apo ndërhyrjet e vazhdueshme të stafit mësimor gjatë zhvillimit të një seance këshillimi. Drejtuesit janë pak të informuar mbi rolin e KSH dhe në disa raste edhe nuk e pranojnë atë.

Vlerësimi nxorri në pah edhe disa çështje të cilat janë thelbësore për mirëfunksionimin e shërbimit psiko-social si për shembull mungesa e qartësisë në dokumentacionin e shkruar (përshkrime pune) mbi rolet e KSH në shkollë (sot punonjësi i SHPSSH), probleme të infrastrukturës së shërbimit, me të cilat ata përballen në sfidën e ndërtimit të sfondit profesional sipas kapacitetit personal të secilit, duke vënë në pikëpyetje standartizimin e shërbimit psiko-social në shkolla dhe cilësinë e tij.

KSH shpesh dhe sipas nevojës kryen një rol të dyfishtë atë të punonjësit social dhe të psikologut, gjë që çënon cilësinë dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimit, si dhe nxit konfuzionin e roleve ndërmjet profesioneve dhe detyrave specifike të tyre.

KSH kanë mbingarkesë për sa i përket numrit të nxënësve që mbulojnë në institucionet të ndryshme (2400 – 3500 nxënës/KSH dhe mesatarisht 2-3 kopshte ose shkolla), gjë që ndikon drejtpërsëdrejti në performancën e tyre dhe kjo rëndohet më tej nga mungesa e një supervizori. Në këtë kontekst rezulton se KSH nuk kanë në dispozicion kohë të mjaftueshme për të realizuar një proces të plotë të identifikimit dhe trajtimit të rasteve problematike në shkollë dhe si rezultat nuk janë në kontakt të vazhdueshëm me nxënësit, gjë që bën të mos jenë të pranishëm gjatë rasteve eventuale të krizave apo dhunës. Mosprezenca në shkollë në çdo ditë të javës ndikon në mosndjekjen e rasteve të cilët mund të përkeqësohen apo të zgjidhen në mënyrë jo profesionale.

KAPITULLI 3

AKTIVITETET E PROJEKTIT “NGRITJA E KAPACITEVE TË KËSHILLUESVE SHKOLLORË MBI DHBGJ” DHE REZULTATET E ARRITURA

Gjatë eskperiencës afro dy vjeçare në punën për fuqizimin e shërbimit psiko-social në shkolla të fokusuar në qytetin e Tiranës dhe Durrësit në kuadër të projektit “*Ngritja e kapaciteteve të Këshilluesve Shkollorë mbi dhunën me bazë gjinore*”, mbështetur nga UNICEF, Shoqata Kombëtare e Punonjësve Socialë zhvilloi një sërë aktivitetesh që synonin pikërisht rritjen e cilësisë së ndërhyrjes për rastet e DHBGJ nga këshilluesit shkollorë.

Me qëllim përfshirjen e të gjitha palëve, në fillim të projektit SHKPS nënshkroi marveshje bashkëpunimi me Drejtorinë Arsimore Rajonale Tiranë, Drejtorinë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë, Drejtorinë Arsimore Rajonale Durrës, Zyrën Arsimore Kavajë dhe zyrën Arsimore Kamëz. Marveshjet e bashkëpunimit përmbanin detyrat dhe përgjegjësitë e secilës palë për zbatimin e aktiviteteve të projektit.

Më poshtë do të përshkruhen aktivitetet kryesore të projektit të zhvilluara gjatë periudhës së zbatimit të projektit:

3.1.1 Vlerësimi i nevojave

Ashtu sikurse është theksuar edhe në kapitullin e mëparshëm në fillim të zbatimit të projektit “Ngritja e kapaciteteve të këshilluesve shkollorë mbi Dhunën me Bazë Gjinore”, u realizua një studim mbi vlersimin e nevojave të KSH. Qëllimi i studimit ishte vlerësimi i nevojave të këshilluesve shkollorë (KSH), mbi dhunën me bazë gjinore (DHBGJ) në shkollat e qarkut të Tiranës dhe të Durrësit për adresimin e këtyre nevojave në trajnimet e parashikuara në kuadër të projektit.

3.1.2 Përgatitja e modulit të trajnimit

Për të adresuar nevojat e identifikuar të KSH nga vlerësimi i përshkruar në kapitullin e mëparshëm, tre ekspertë të DHBGJ u angazhuan në zhvillimin e një moduli trajnimi, i cili u fokusua në njohuri mbi shenjat dalluese dhe metoda të identifikimit të rasteve të DHBGJ, mbështetjen e viktimave/fëmijëve/adoleshentëve nëpërmjet këshillimit dhe metodave të tjera të punës në grup, apo referimeve dhe bashkëpunimeve të mundshme me shërbime të specializuara. Për përgatitjen e modulit të trajnimit, ekspertët punuan ngushtësisht dhe u konsultuan në vazhdimësi me profesionistët e SHKPS, DAR dhe UNICEF. Moduli i trajnimit shërbeu si një bazë shumë e mirë informacioni për përgatitjet e trajnerëve të cilët zhvilluan më pas sesionet e trajnimit me këshilluesit shkollorë në qarkun e Tiranës dhe Durrësit.

Objektivat e Modulit të trajnimit ishin :

- *Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit, njohurive dhe aftësive të këshilluesve shkollorë në identifikimin, raportimin dhe trajtimin e të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore në mesin e fëmijëve dhe adoleshentëve.*
- *Rritja e kapaciteteve të KSH në trajtimin dhe referimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore në mesin e adoleshentëve.*

Çështjet kryesore të përfshira në modulën e trajnimit janë:

- Koncepti i dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore dhe specifikisht i dhunës ndërmjet adoleshentëve;
- Identifikimi i fëmijëve/adoleshentëve të abuzuar;
- Llojet e abuzimit të fëmijëve/adoleshentëve dhe mënyrat e identifikimit;
- Pasojat e abuzimit dhe profili i fëmijëve të abuzuar;
- Menaxhimi i rastit. Drejtimet teorike dhe metodat e menaxhimit të rastit;
- Dizenjimi i një plani ndërhyrje për menaxhimin e rasteve;
- Trajtimi kompleks: familja, mësuesi dhe bashkëmoshatarët;
- Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri. Agjencitë dhe shërbimet kombëtare, të cilat trajtojnë rastet e dhunës në familje dhe kuadri ligjorë;
- Teknikat e këshillimit individual dhe në grup;
- Këshillimi i fëmijëve dhe adoleshentëve;
- Puna me grupet për ndërgjegjësim dhe parandalim;
- Metodatat dhe aftësitë e trajnimit me të rriturit, etj.

3.1.3 Organizimi i trajnimit për trajnerë (ToT)

Stafi i SHKPS në bashkëpunimi me ekspertët e modulit të trajnimit organizoi një trajnim tre ditor për trajnerë ToT, të cilët më pas zhvilluan sesionet e trajnimit me Këshilluesi Shkollorë në qarkun e Tiranës dhe Durrësit. Qëllimi i këtij trajnimit ishte krijimi i një grupi trajnerësh të specializuar mbi DHBGJ, të cilët do të shërbejnë edhe si një aset për projekte të ngjashme në vazhdimësi.

Pjesëmarrësit në ToT u përzgjodhën në bazë të profesionit, ekspertizës dhe nivelit të njohurive mbi dhunën me bazë gjinore. Grupi i trajnerëve përbëhej nga 12 persona me formim në punë sociale, psikologji, specialistë edukimi dhe këshillues shkollorë të cilët punojnë në këtë fushë që në krijimin e këtij shërbimi në vëndin tonë.

Trajnimet për trajnerë (ToT) ofruan njohuri dhe aftësi praktike mbi DHBGJ, menaxhimin e rastit, këshillimin individual në trajtimin e rasteve të DHBGJ, punën me grupe si dhe aftësi trajnuese nëpërmjet metodave interaktive të të mësuarit.

Gjatë sesioneve ToT pjesmarrësit u trajnuan mbi çështje e mëposhtme:

- Konceptet kryesore të dhunës me bazë gjinore, abuzimi i fëmijëve dhe adoleshentëve, dhuna me baze gjinore ndaj vajzave adoleshente;
- Shenjat dhe pasojat e abuzimit dhe profili i fëmijëve të abuzuar;
- Menaxhimi i Rastit. Hartimi një plani ndërhyrje për menaxhimin e rastit;
- Trajtimi kompleks i rasteve të DHBGJ, përfshirja e familjes, mësuesve dhe bashkmoshatarëve;
- Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri;
- Teknikat e këshillimit individual dhe në grup për fëmijët e abuzuar;
- Aftësitë e punës në grup dhe me grupe;
- Aftësitë dhe metodat e organizimit dhe zhvillimit të trajnimeve.

3.1.4 Organizimi i sesioneve të trajnimeve me këshilluesit shkollorë

Me qëllim rritjen e aftësive të këshilluesve shkollorë mbi identifikimin, trajtimin dhe referimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, në kuadër të projektit, u zhvilluan 6 sesione trajnimi 3 ditore, me 83 Këshilluesit Shkollorë në qarkun e Tiranës dhe Durrësit. Trajnimet u zhvilluan sipas një kalendarit të hartuar në bashkëpunim me DAR-et përkatëse dhe trajnerët gjatë periudhës Janar – Prill 2014.

Programi për çdo sesion trajnimi u përpilua nga çiftet e trajnerve të trajnuar në fazën e mëparshme të projektit, të cilët përzgjedhën informacione/njohuri dhe metodat specifike interaktive për trajnim, të tilla si leksione të shkurtra, ushtrime, punë në grupe, rol play, brainstorming, bazuar në

programin e paraqitur gjatë ToT. Gjatë sesioneve pjesëmarrësve i'u dha mundësia të diskutonin dhe të ndanin raste konkrete nga puna përditshme dhe eksperiencia me raste të vështira.

Një rëndësi e veçantë i'u kushtua menaxhimit të rastit si një metodë shumë efektive me rastet e DHBGJ dhe e cila rezultoi të jetë pak e aplikuar në fushën e shërbimit psiko-social në shkolla si edhe ndërtimit të planeve individuale për raste e DHBGJ. Të ndarë në grupe punë të vogla atyre i'u dha mundësia të ndërtojnë plane ndërhyrje individuale për raste konkrete të dhëna nga trajnerët dhe t'i diskutonin më pas në një grup më të madh.

3.1.5 Organizimi i trajnimeve “on the spot” me Këshilluesit Shkollorë

Një aktivitet shumë i rëndësishëm i projektit “*Ngritja e kapaciteteve të këshilluesve shkollorë mbi dhunën me bazë gjinore*” ishin dhe organizimi i trajnimeve “on the spot” apo ndryshe i trajnimeve në vendin e punës, si një mënyrë alterantive bashkëkohore dhe shumë efektive e rritjes së kapaciteteve profesionale të KSH.

Qëllimi i zhvillimit të trajnimeve “on the spot” ishte për të ndjekur në vazhdimësi mënyrën e përdorimit të aftësive të përfituara në trajnime si dhe ndikimin e tyre në praktikë, duke asistuar disa nga KSH në vëndin e punës, kryesisht fokusuar në rastet më të vështira të DHBGJ. Këto sesione trajnimi u zhvilluan në dy pjesë, ku në pjesën e parë të ditës mbështetej një KSH në vëndin e punës dhe në pjesën e dytë në një grup më të gjërë u zhvilluan seanca intervizioni, si një praktikë pozitive e supervizionit të brëndshëm për rastet më problematike, në kushtet kur mungon supervizioni profesional dhe i strukturuar. Në total u zhvilluan 6 trajnime në vëndin e punës (on the spot) ku u asistuan drejtpërdrejt 6 këshillues shkollorë për ndërtimin e planeve individuale, menaxhimin e rasteve problematike dhe ndërtimin e planeve të punës, si edhe morën pjesë në procesin e intervizionit 78 këshillues shkollorë të qarkut të Tiranës dhe Durrësit.

3.1.6 Përgatitja dhe publikimi i fletpalosjeve informuese

Një ekspert me eksperiencë në fushën e DHBGJ përgatiti fletpalosje informuese për të informuar adoleshentët në një shkallë më të gjërë rreth llojeve, efekteve dhe pasojave të dhunës me bazë gjinore dhe profesionistëve, institucioneve ku ato mund të drejtohen në lidhje me këto çështje. Fletpalosja u publikua në 4500 kopje të cilat janë shpërndarë tek profesionistët në mënyrë që ato të mund t'i përdorin gjatë aktiviteteve që organizojnë në kuadër të planeve vjetore me adoleshentët.

3.1.7 Përgatitja dhe publikimi i Manualit të Referencës për DHBGJ

Nga sesionet e trajnimit të zhvilluara me këshilluesit shkollorë dhe nga nevojat e ardhura nga vetë ata, lindi domosdoshmëria për hartimin e një manuali punë lidhur me DHBGJ. Ekspertët e SHKPS me eksperiencë në fushën e dhunës me bazë gjinore, kuadrin ligjor të dhunës dhe fushën e shërbimit psiko-social në shkolla përgatitën Manualin e Referencës për punonjësit e SHPSSH, *“Njohuri dhe teknika specifike për trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të DHBGJ”*. Manuali i referencës është i fokusuar kryesisht në njohuritë dhe aftësitë e punës lidhur me DHBGJ, identifikimin dhe adresimin e nevojave psiko-sociale të këtyre rasteve, mbështetjen e viktimave/adoleshentëve me këshillim dhe referim tek shërbimet e specializuara.

Ky manual do të ndihmojë në rritjen e nivelit të njohurive dhe forcimin e aftësive të këshilluesve shkollorë në punën me rastet e DHBGJ fokusuar kryesisht tek adoleshentët dhe do të shërbejë si një instrument për KSH jo vetëm për procesin e trajnimit por edhe në punën e tyre të përditshme me rastet e DHBGJ. Manuali bazohet jo vetëm në nevojat identifikuar nga vlerësimi i kryer në fillim të projektit, por reflekton gjithashtu opinione dhe eksperiencat e identifikuar nga pjesëmarrësit gjatë sesioneve të trajnimit apo njohuri dhe modele praktike nga burime të tjera.

Manuali i Referencës është publikuar në 300 kopje dhe do të shpërndahet tek të gjithë KSH

dhe palët e interesuara, siç janë përfaqësuesit e Drejtorive Arsimore Rajonale, OJF-të që janë të fokusuara në dhunën me bazë gjinore tek adoleshentët dhe tek aktorët e tjerë.

3.1.8 Takim përmbyllës me palët e interesuara

Në përmbyllje të aktiviteteve të projektit u organizua në Tiranë një takim përmbyllës me pjesmarrjen e përfituesve direkt të projektit si, këshilluesit shkollorë, përfaqësues nga shkollat e targetuara, DAR/ZA, UNICEF, MMSR, MAS, ekspertë të çështjeve gjinore, si dhe përfaqësues nga OJF-të partnere dhe aktorë të tjerë të fushës.

Ky takim shërbeu si një mundësi e mirë për të prezantuar rezultatet e projektit, për të finalizuar rekomandimet dhe për të promovuar praktikat më të mira të shërbimit psiko-social në shkollat tona. Takimi u moderua nga 2 ekspertë të çështjeve gjinore, të cilët u ndalën specifikisht në dhunën me bazë gjinore ndaj vajzave/adoleshenteve dhe në rolin e punonjësit të SHPSSH, si një pikë kyçe në adresimin e këtyre rasteve, si edhe prezantuan situatën aktuale të shërbimit psiko-social në shkolla.

Një çështje tjetër e rëndësishme ishte diskutimi rreth mësimave të nxjerra gjatë implementimit të projektit dhe dhënia e sugjerimeve mbi metodat dhe praktikat më të mira të ofrimit të shërbimit psiko-social në shkolla. Materialet e publikuara gjatë projektit për palët e interesuara si Fletëpalosje, Manuali i Referencës dhe Raporti i Projektit u shpërndanë gjatë takimit për të gjithë pjesëmarrësit.

3.2 REZULTATET E PROJEKTIT “NGRITJA E KAPACITETEVE TË KËSHILLUESVE SHKOLLORË MBI DHBGJ”

Ndërhyrja gati dy vjeçare në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të këshilluesve shkollorë, fokusuar kryesisht në rastet e dhunës me bazë gjinore në qarkun e Tiranës dhe Durrësit, rezultoi e domosdoshme dhe vlefshme për KSH. Disa nga rezultatet e arritura gjatë projektit janë:

- Realizimi i **studimit mbi vlersimin e nevojave të KSH**, i cili identifikoi në një nivel më të gjërë problematikat me të cilat ndeshet shërbimi psiko-social në shkolla dhe jo vetëm me rastet e DHGBJ;

-Përgatitja e nje **moduli trajnimi** mbi dhunën me bazë gjinore i cili do të jetë një bazë e fortë për punën e KSH me rastet e dhunës me bazë gjinore;

-Organizimi i tre ditëve **trajnim për trajnerët ToT** dhe krijimi i një grupi trajnerësh i përbërë nga 12 profesionistë, të cilët zhvilluan sesionet e trajnimit me KSH në qytetet e targetuara dhe të cilët janë një aset për programe të ngjashme në të ardhmen;

-Përgatitja, publikimi dhe shpërndarja e **4500 fletpalosjeve informuese për DHBGJ**, drejtuar nxënësve të shkollave të targetuara.

-Trajnimi i 83 Këshilluesve Shkollorë në qarkun e Tiranës dhe Durrësit, nëpërmjet zhvillimi të **6 sesioneve 3 ditore të trajnimit**.

-Zhvillimi i **6 trajnimeve “on the spot”** dhe asistimi në vëndin e punës i këshilluesve shkollorë mbi planet individuale dhe dokumentacionin mbështetës.

-Përgatitja, publikimi dhe shpërndarja e **300 kopjeve të Manualit të Referecës** për Këshilluesit Shkollorë të Qarqeve të Tiranës dhe Durrësit.

KAPITULLI 4

TEMAT E TRAJNIMIT DHE REAGIMET E MARA NGA PJESMARRËSIT NË TRAJNIME

Trajnimet tre ditore të zhvilluara me këshilluesit shkollorë të qarkut të Tiranës dhe Durrësit, siç është përmëndur edhe më lart, ofruan një sërë njohurish teorike dhe praktike lidhur me punën me rastet e dhunës me bazë gjinore fokusuar te adoleshentët. Trajnimet u strukturuan/ndanë në 11 sesione kryesore përgjatë tre ditëve. Më poshtë janë paraqitur çështjet e trajtuara gjatë sesioneve të trajnimeve me këshilluesit shkollorë:

4.1 SESIONET E TRAJNIMEVE

Sesioni 1: Njohja e pjesëmarrësve me njëri-tjetrin dhe trajnimin.

Në këtë sesion i'u kushtua një rëndësi e veçantë prezantimit të pjesmarrësve, historisë dhe domethënies së emrit, me qëllim krijimin e një atmosfere miqësore dhe komunikuese pune por edhe për ta lidhur më pas me çështjet gjinore. Gjithashtu në këtë sesion u bë një shpjegim i detajuar i projektit në tërësi dhe përmbajtjes së trajnimit në veçanti, mbi objektivat, pritshmëritë dhe kontributet e gjithsecilit gjatë trajnimit. Pjesë e rëndësishme e këtij sesioni ishte gjithashtu vlerësimi i nivelit të njohurive dhe qëndrimeve të pjesëmarrësve në lidhje me dhunën në familje, dhunën me bazë gjinore, abuzimin e fëmijëve si edhe të çështjeve të tjera që lidhen me metodat e punës me rastet e DHBGJ.

Sesioni 2: Përcaktimi dhe kuptimi i koncepteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Përcaktimi i abuzimit të fëmijëve dhe adoleshentëve.

Ky sesion u fokusua në përforsimin dhe thellimin e njohurive tek pjesëmarrësit mbi kuptimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore si edhe në krijimin e një kuptueshmërie më të mirë dhe një përcaktimi më të unifikuar të konceptit të abuzimit të fëmijëve/adoleshentëve dhe formave të këtij abuzimi si ai fizik, seksual, emocional, psikologjik, neglizhimi, shfrytëzimi dhe trafikimi. Fillimisht nëpërmjet punëve në grupe, pjesëmarrësit arritën të jepnin një definicion për secilin nga llojet e abuzimit dhe më pas u plotësohej informacioni nëpërmjet prezantimit teorik nga trajnerët.

Konceptet/Çështjet kryesore të trajtuara në këtë sesion ishin:

1. Përforsimi dhe kuptimi i dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore;
2. Përcaktimi dhe kuptimi i konceptit të abuzimit të fëmijës dhe adoleshentëve si edhe formave të abuzimit ;
3. Abuzimi fizik;
4. Abuzimi seksual;
5. Abuzimi psikologjik/emocional;
6. Neglizhimi;
7. Shfrytëzimi;
8. Trafikimi.

Sesioni 3: Shenjat e formave të ndryshme të abuzimit tek fëmijët/adoleshentët dhe teknikat e identifikimit të rastit.

Bazuar në shtjellimin dhe qartësimin e koncepteve mbi format e dhunës në sesionin e dytë pjesëmarrësit u fokusuan në ekzaminimin/shtjellimin e shenjave dhe simptomave të formave të ndryshme të abuzimit si dhe të teknikave të identifikimit të rastit, tipologjisë/llojit të abuzimit.

Çështjet kryesore të trajtuara në këtë sesion ishin:

1. Shenjat e abuzimit fizik, seksual, psikologjik dhe emocional tek fëmijët/adoleshentët;
2. Simptomat e abuzimit fizik, seksual, psikologjik, emocional tek fëmijët/adoleshentët;
3. Identifikimi i tipologjisë/llojit të abuzimit.

Sesioni 4: Pasojat e abuzimit dhe profili i fëmijëve të abuzuar.

Ky sesion synoi të thellojë tek pjesëmarrësit informacionin dhe njohuritë mbi pasojat e abuzimit tek fëmijët/adoleshentët si dhe profilin e fëmijëve/adoleshentëve të abuzuar. Nëpërmjet rasteve konkrete, pjesëmarrësit identifikuan pasojat afatshkurtra dhe afatgjata të abuzimit. Pjesë e rëndësishme e këtij sesioni ishin gjithashtu në terma të përgjithshme llojet e shërbimeve dhe ndërhyrjeve që janë të nevojshme për të ndihmuar fëmijët/adoleshentët e abuzuar.

Çështjet kryesore të trajtuara në këtë sesion ishin:

1. Pasojat fizike dhe seksuale të abuzimit tek fëmijët/adoleshentët;
2. Pasojat emocionale dhe psikologjike të abuzimit tek fëmijët/adoleshentët;
3. Profili i fëmijëve të abuzuar.

Sesioni 5: Fëmijët/adoleshentët në rrezik dhe profili i familjeve në rrezik të lartë të

Abuzimit.

Ky sesion u fokusua tek treguesit dhe faktorët e rrezikut që i bëjnë fëmijët më vulnerabël dhe të ekspozuar ndaj fenomenit të abuzimit. Duke njohur këta tregues dhe faktorë rreziku, vëmendja dhe ndërhyrja e profesionistëve do të jetë më efikase në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të abuzimit ndaj fëmijëve/adoleshentëve të abuzuar.

Çështjet kryesore që u diskutuan në këtë sesion ishin:

1. Fëmijët/adoleshentët në rrezik;
2. Profili i familjeve në rrezik të lartë të abuzimit.

Sesioni 6: Menaxhimi i rastit; metoda specifike të menaxhimit të rastit.

Ky sesion u përqendrua në përcaktimin e menaxhimit të rastit, në aspekte të përgjithshme të modeleve dhe qasjeve për menaxhimin e rastit si dhe në eksplorimin se si menaxhimi i rastit është i lidhur me praktikën e punës së Shërbimit psiko-social në shkolla (duke theksuar qasjen e punës në ekipe multidisiplinare dhe fokusin tek fëmijët/adoleshentët). Gjatë sesionit u diskutua rëndësia e kësaj qasje në menaxhimin e rastit në punën për mbrojtjen e fëmijëve dhe adoleshentëve në mjediset shkollore.

Çështjet kryesore të trajtuara në këtë sesion ishin:

1. Përcaktimi i menaxhimit të rastit;
2. Parimet kryesore të procesit të menaxhimit të rastit;
3. Qasjet teorike mbi menaxhimin e rastit.

Sesioni 7: Ndërtimi i një plani ndërhyrje për menaxhimin e rastit. Trajtimi shumëplanësh: familja, mësuesi/sja dhe bashkëmoshatarët.

Ky ishte një sesion i rëndësishëm sepse pjesëmarrësit u ftuan të diskutojnë për hapat që duhet të ndërmerren në menaxhimin e rastit dhe kohëzgjatjen e tyre si dhe të reflektonin mbi sfidat e mundshme përgjatë këtyre hapave. Gjithashtu në këtë sesion pjesëmarrësit diskutuan gjërësisht me qëllim hartimin e një skeme me të gjitha hapat që duhen zbatuar nga KSH për çdo rast që ka nevojë për mbrojtje që është referuar apo identifikuar nga KSH dhe aktorët e tjerë të shkollës. Ky sesion synoi t'i përfshijë pjesëmarrësit më konkretisht në diskutimin për menaxhimin e rastit në situatat kur fëmija ndodhet në rrezik.

Një pjesë e rëndësishme iu kushtua gjithashtu hartimit të planit individual të menaxhimit të rastit, bazuar në modelin e planit individual për Mbrojtjen e fëmijëve (Sipas Protokollit të NjMF-së) dhe trajtimit shumëplanësh, kombinimi i familjes, mësuesit/ses dhe bashkëmoshatarëve në trajtimin e rasteve.

Çështjet kryesore të trajtuara në këtë sesion ishin:

1. Proçesi i Menaxhimit të Rastit;
2. Modeli i planit individual të menaxhimit të rastit (Sipas Protokollit të NjMF-së);
3. Trajtimi shumëplanësh - kombinimi i familjes, mësuesit/ses dhe bashkëmoshatarëve në trajtimin e rasteve.

Sesioni 8: Njohuri/informacion mbi sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, sistemin e referimit, agjencitë apo shërbimet kombëtare, rajonale apo lokale specifike që trajtojnë rastet e dhunës në familje dhe kuadrin ligjor.

Ky sesion u fokusua në qartësimin e kornizës ligjore që siguron mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri. Sesioni kishte si qëllim të japte njohuri të nevojshme pjesëmarrësve mbi kuadrin ligjor që garanton mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe që është i zbatueshëm në vend si dhe ti prezantonte ata me Mekanizmin Kombëtar të referimit të rasteve të dhunës në familje dhe me institucionet /agjencitë në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve.

Çështjet kryesore të trajtuara në këtë sesion ishin:

1. Kuadri ligjor për të drejtat e fëmijëve në Shqipëri;
2. Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve në nivel rajonal;
3. Njësitë e mbrojtjes së fëmijëve në nivel lokal Bashki/Komuna;
4. Mekanizmi Kombëtar i Referimit të Rasteve të Dhunës në familje MKR;
5. Agjencitë/ institucionet që ofrojnë shërbime për fëmijët.

Sesioni 9: Teknika të këshillimit individual dhe në grup. Shprehi bazë të intervistimit dhe këshillimit.

Në këtë sesion u rifreskuan njohuritë dhe disa shprehi kryesore të intervistimit dhe këshillimit, duke u fokusuar fillimisht në dallimin midis përdorimit të këtyre dy metodave të punës me individë dhe grupe. Një vëmendje e veçantë iu kushtua eksplorimit bashkë me pjesëmarrësit të njohurive dhe shprehive që ata kanë nga praktika në mjediset shkollore mbi intervistimin dhe këshillimin si edhe të përdorimit të tyre në situata të ndryshme dhe specifikisht të rasteve të DHBGJ.

Çështjet kryesore të trajtuara në këtë sesionin ishin:

1. Intervistimi dhe këshillimi;
2. Shprehitë e ndjekjes së sjelljes;
3. Shprehitë e vëzhgimit;
4. Shprehitë e pyetjeve;
5. Shprehitë e inkurajimit, perifrazimit dhe përmbledhjes;
6. Intervista me 5 faza; Cikli vendimmarrjes.

Sesioni 10: Teknikat e këshillimit të fëmijëve dhe adoleshentëve.

Sesioni synoi të përforconte dhe thellonte tek pjesëmarrësit njohuritë dhe aftësitë në përdorimin e metodave të intervistimit dhe këshillimit në praktikën me fëmijët dhe adoleshentët.

Çështjet kryesore të trajtuara në këtë sesion ishin:

1. Intervistimi i fëmijëve dhe adoleshentëve ;
2. Specifika të intervistimit të fëmijëve/adoleshentëve nga profesionistët;
3. Disa shprehi të komunikimit me fëmijët/adoleshentët;
4. Pyetje, sjellje dhe qëndrime që duhen mbajtur parasysht gjatë intervistimit të fëmijëve në situata të caktuara.

Sesioni 11: Puna me grupet për ndërgjegjësim dhe parandalim. Metoda dhe aftësi të punës me adoleshentët.

Në këtë sesion fokusi u përqëndrua në përforsimin tek pjesëmarrësit të njohurive dhe aftësive në përdorimin e metodave të punës me grupet për ndërgjegjësim dhe parandalim si dhe rëndësinë e lojrave psiko-sociale dhe tradicionale në punën për ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe adoleshentëve lidhur me çështjet e abuzimit.

Çështjet kryesore të trajtuara në këtë sesion ishin:

1. Grupet edukuese;
2. Grupet e rritjes;
3. Grupet socializuese;
4. Rëndësia e lojërave psiko-sociale dhe tradicionale në mbrojtjen e fëmijëve.

4.2 VLERËSIME TË PJESMARRËSVE MBI PËRMBATJEN DHE PROÇESIN E ORGANIZIMIT TË TRAJNIMEVE

Nga analiza e pyetësorëve të vlerësimit, fokus grupet dhe raportet e trajnerëve për çdo trajnim rezulton se pjesëmarrësit në sesionet e trajnimit dhe në trajnimet “on the spot”, vlerësojnë si shumë të nevojshëm dhe të rëndësishëm për punën e tyre njohuritë dhe aftësitë e përfituara gjatë këtyre trajnimeve. Lidhur me ***Përmbajtjen e trajnimit*** ndër çështjet më të rëndësishme ata veçojnë:

- Menaxhimin e rasteve dhe shpjegimin e rasteve konkrete dhe trajtimin e tyre;
- Njohja me teknikat specifike të menaxhimit të rastit dhe informimi mbi sistemin e referimit;
- Planet individuale të mbrojtjes për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore;
- Kudrin ligjorë dhe mekanizimin e referimit të rasteve të DHBGJ;
- Metodat për identifikimin e rasteve të DHBGJ;

- Llojet e dhunës, shenjat dhe pasojat;
- Diskutimi mbi trajtimin e rasteve konkrete.

Ndërsa për sa i përket **proçesit të trajnimit**, pjesëmarrësit vlerësojnë si shumë të rëndësishme aspektet e mëposhtme:

- Cilësia e lartë dhe bashkëkohore e informacionit;
- Ilustrimi dhe përdorimi i rasteve konkrete;
- Diskutimi i rasteve dhe ndarja e eksperiencave;
- Sugjerime dhe këshilla konkrete për zgjidhjen e rasteve;
- Koordinimin e metodave të trajnimit: role-play, diskutime, lojrave dhe informacionit teorik;
- Komunikimi shumë i mirë trajnëre/pjesëmarrës;
- Trajnimet on the spot.

4.3 PENGESA PËR APLIKIMIN E NJOHURIVE TË PËRFITUARA GJATË TRAJNIMEVE

Gjatë fokus grupeve vlerësuese të projektit, Këshilluesit Shkollorë shprehen se edhe pse trajnimi ishte shumë i vlefshëm për ta, janë disa situata/kushte rrethore që do ti pengonin ata në disa raste të aplikonin njohuritë e tyre të marra gjatë këtyre trajnimeve. Disa faktorë që ata vlerësonin si përcaktues në këtë proçes ishin:

- Mungesa e strukturave në mbështetje të rasteve;
- Problemet e bashkëpunimit me aktorët e tjerë në mjediset ku punojnë;
- Mungesa e mjediseve të përshtatshme në shkolla për zhvillimin e takimeve, këshillimin dhe punën në grupe;
- Moskordinimi i aktorëve të ndryshëm për menaxhimin e rasteve;
- Mosfunktionimi i zinxhirit referues dhe mungesa e shërbimeve;

-
- Mungesa e dokumentacionit dhe planeve të standartizuara;
 - Vështirësitë e punës së përditshme si mungesa e një ambient në çdo shkollë, numri shumë i lartë i nxënësve;
 - Mentaliteti tradicional në familje, shkollë dhe komunitet.

KAPITULLI 5

REKOMANDIME MBI ORGANIZIMIN E AKTIVTETEVE TRAJNUESE

Shërbimi psiko-social në vëndin tonë, si një shërbim relativisht i ri dhe jo me shumë eksperinca në trajtimin e çështjeve specifike siç është edhe dhuna me bazë gjinore me fokus adoleshentët, sjell nevojën e zhvillimit të trajnimeve në vazhdimësi, të shtrira në të gjithë territorin e vendit.

Në këtë kontekst, më poshtë janë paraqitur disa ide mbi mënyrat sesi mund të organizohen në vazhdimësi trajnime alternative për fuqizimin e punonjësve të shërbimit psiko-social në shkolla:

5.1 Trajnimet në vazhdimësi mbi çështjen e DHBGJ

Në realitetin e shërbimit psiko-social në shkolla sesionet tradicionale të trajnimit mbeten të nevojshme edhe në fuqizimin e shërbimit psiko social në punën me rastet e dhunës me bazë gjinore. Në eksperiencën tonë me KSH në implementimin e projektit “*Ngritja e kapaciteteve të këshilluesve shkollorë mbi DHBGJ*” u vu re se nevoja për trajnime në vazhdimësi mbi këtë fushë është shume e madhe sidomos te trajnimet mbi protokollet dhe instrumentat e punës me këto raste, planet individuale për rastet e DHBGJ, identifikimi, trajtimin dhe referimin e këtyre rasteve të fokusuara kryesisht tek vajzat adoleshente. Në të njëjtën kohë, këto sesione trajnimi duhet të fokusohen më gjërësisht edhe tek ofrimi i metodave alternative të punës në grupe dhe në kuadrin e ekipeve multidisiplinare, të

ndryshme nga ato që ofrohen aktualisht në shkollat tona.

Zhvillimi i trajnimeve në vazhdimësi duhet të synojë jo vetëm prezantimin e metodologjive më bashkëkohore në punën për identifikimin dhe trajtimin e rastet individuale apo punës me grupe edukuese, por edhe përditësimin me format dhe tendencat dinamike të shfaqjes së DHBGJ. Njëkohësisht vlerësohet si i domosdoshëm dhe rifreskimi i njohurive dhe shprehive të punës së përditshme të PSHPSSH lidhur me DHBGJ.

Programi i trajnimit në vazhdimësi duhet të përfshihet në një sistem akreditimi, në mënyrë që të sigurojë standartet bashkëkohore të ofrimit të një shërbimi cilësor dhe në përshtatje me nevojat specifike të profesionistëve të rinj që në vazhdimësi do të përfshihen në shërbim.

5.2 Trajnime të vazhdueshme në vendin e punës

Nga eksperiencia e projektit dhe vlerësimet e pjesëmarrësve rezultoi se trajnimet ‘on the spot’ apo ndryshe në vendin e punës, janë një mënyrë shumë efektive për fuqizimin e punonjësve të SHPSSH lidhur me DHBGJ. Mbështetja me ekspertizë profesionale gjatë punës me raste konkrete duket se është një metodë shumë e mirë për të orientuar PSHPSSH në punën e tyre me këto raste, si në metodat e identifikimit që duket se janë ende të varfëra, ndërtimin e planeve individuale për trajtimin e rasteve, por edhe në përdorimin e metodave alternative për informim dhe ndërgjegjësim.

5.3 Forumet dhe supervizioni online

Një mënyrë tjetër alternative për të fuqizuar ofruesit e SHPSSH, do të ishin edhe forumet online, ku profesionistët e këtij shërbimi mund të shkëmbejnë informacion mbi punën e përditshme. Këto forume mund të përmbajnë diskutime mbi tematika të caktuara që lidhen me DHBGJ, adresa të dobishme informacioni të cilat janë ndihmuese në punën e tyre. Gjithashtu supervizioni online mund të jetë në formën e një blogu, në të cilin supervizori lidhet me profesionistët e tjerë duke iu

dhënë atyre çdo ditë një temë të caktuar dhe këshilla rreth asaj teme. Në rastet kur profesionistët kanë dilema në punën e tyre mund të lidhen drejtpërdrejt online me supervizorin dhe të diskutojnë më hollësisht. Kjo është një metodë e shpejtë, me kosto të ulët dhe që stimulon bashkëbisedimin ndërmjet profesionistëve dhe supervizorit.

5.4 Trajnime peer to peer

Për të fuqizuar shërbimin psiko-social në punën me rastet e DHBGJ fokusuar tek adoleshentët do të ishin të aplikueshme edhe trajnimet peer to peer, apo në rastin tonë ndërmjet vetë profesionistëve. Krijimi i grupeve të profesionistëve të SHPSSH të pajisur me aftësi teorike dhe praktike mbi DHBGJ, të cilët më pas mund të jenë trajnerë për pjesën tjetër të ofruesve të SHPSSH, do të ishte një mëyrë efektive për fuqizimin e këtij shërbimi por edhe një mënyrë e mirë për të shkëmbyer eksperiencën ndërmjet tyre.

KAPITULLI 6

NJË ANALIZË MBI SITUATËN AKTUALE TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NË SHKOLLA

6.1 HISTORIKU I SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NË SHQIPËRI

Në vjeshtën e vitit 2004, MASH me Urdhërin nr.321, datë 11.10.2004 për “*Eksperimentimin e shërbimit psikologjik në sistemin e arsimit parauniversitar*” ligjëroi ngritjen e “Qendrave të shërbimit psikologjik” në të gjitha shkollat e arsimit të detyruar 9-vjeçar dhe arsimit të mesëm të zonës urbane të vendit.

Kjo nismë, lindi si një domosdoshmëri për adresimin e problematikave me të cilat po përballlej shkolla dhe shoqëria jonë. Prej kohësh, probleme të shumta të përparimit të nxënësve në shkollë dhe vështirësitë që hasnin, problemet e disiplinës, problemet e dhunës, përdorimi i alkoolit dhe drogës në shkollë e një sërë problemesh të kësaj natyre kërkonin një trajtim sa më efikas dhe me një qasje të re psikologjike, por edhe sociale nga persona të përgatitur për këto probleme. Për t’iu përgjigjur kësaj game të gjerë të nevojave, ngritja e shërbimit psikologjik, pranë shkollave u pa si një mënyrë shumë e mirë nga të gjithë aktorët, mësuesit e drejtuesit e shkollave, specialistët e arsimit, prindërit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Më pas në vitin 2008, pas një vlerësimi të shërbimit në bazë të *Urdhrit Nr .2760, datë 23.04.2008*, ky shërbim u njoh zyrtarisht, dhe në të njëjtën kohë u synua shtrirja e tij në të gjitha shkollat e

vendit.

Më pas me miratimin e Ligjit për Arsimin Parauniversitar Nr 69/ 2012, shërbimi psikologjik ndryshoi fokusin e tij duke e zgjeruar atë në një shërbim më kompleks: *“Shërbimi psiko-social ofron mbështetje nëpërmjet psikologëve ose punonjësve socialë për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psiko-sociale, hartimin e programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit shkollor”*⁶

Në zbatim të Ligjit të mësipërm, lëshohet Urdhri Nr. 344 datë 19.08.2013 për *“Ngritjen e Njësisë së Shërbimit psiko-social në institucionet arsimore”*, i cili i vendos drejtuesit e DAR-ve/ZA-ve përpara përgjegjësisë për të ngritur njësitë psiko-sociale të përbëra nga punonjës social dhe psikologë.

Edhe pse ka kaluar thajse një dekadë nga nisja e këtij shërbimi, ai vazhdon të ketë një shtrirje të kufizuar dhe të përballet me shumë sfida, disa prej të cilave i'u është dhënë zgjidhje me kalimin e viteve dhe disa të tjera rezultojnë të jenë ende problematike. Disa prej këtyre sfidave lidhen me numrin e lartë të shkollave dhe nxënësve që punonjësit mbulojnë, mungesën e supervizimit profesional, mungesën e infrastrukturës, etj.

6.2 BAZA LIGJORE PËR SHËRBIMIN PSIKO-SOCIAL NË VËNDIN TONË

Legjislacioni mbi të cilën është ngritur dhe mbështetur shërbimi psiko-social shkollor, është i bazuar në parimet dhe filozofinë e këtij shërbimi në vëndet e zhvilluara. I nisur si një projekt pilot, në vitin 2004, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) miratoi vendimin nr. 321, *“Eksperimentimi i shërbimit psikologjik në sistemin arsimor parauniversitar në vitet shkollore 2004-2005-2006”*⁷.

Vendimi përmbante kritere mbi cilësinë e punonjësit të shërbimit psikologjik, arsimin e tij specifik, qëllimin thelbësor të psikologut shkollor si specialist i shërbimit psikologjik që bashkëpunon me aktorët kryesorë si: nxënësit, mësuesit dhe prindërit, duke ndikuar në vlerësimin e rezultateve të nxënësit,

⁶ Ligj nr. 69/2012, Për sistemin arsimor parauniversitar në republikën e shqipërisë

⁷ MASH, 2004

zhvillimin psiko-social, emocional të tyre si edhe në orientimin shkollor e profesional. Ky vendim pas vitit 2006 e shëndrroi periudhën eksperimentale në një vendim të formës së prerë e të pakthyeshëm për shtrirjen dhe zbatimin e shërbimit psikologjik në vazhdimësi.

Viti 2008 është një vit tjetër vendimntar për shërbimin psiko-social në shkolla, në të cilin MASH rifreskon dhe përforcon vendimin për shtrirjen e këtij shërbimi në të tërë sistemin arsimor parauniversitar. Vendimi më i fundit, i cili vë theksin mbi zhvillimin cilësor të këtij shërbimi, është vendimi i nëntorit të 2011. Në këtë vendim theksohet shtrirja e këtij shërbimi si në zonat urbane edhe në zonat rurale, për të gjitha grupmoshat nga 0 deri 18 vjeç, pra shtrirja e këtij shërbimit në kopshte, sistemin parashkollor, fillor, 9-vjeçar dhe atë të mesëm.

Ligji i Arsimit Parauniversitar 2012⁸ parashikon ngritjen e shërbimit psiko-social në institucionet arsimore. Ky ligj sjell risi përsa i përket shtimit të dimensionit social, dhe emërtimit të shërbimit tashmë nga psikologjik në shërbim psiko-social, duke vënë theksin te puna në grupe multidisiplinare dhe roli shumë i rëndësishëm i punonjësit social në këtë grup. Retorika e formulimit të këtyre dokumenteve dhe rregullimeve ligjore sërish përqendrohet në konsiderimin e shërbimit psiko-social të fokusuar kryesisht në “trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme”, por nga ana tjetër zgjeron gamën e veprimtarive që duhet të mbulojë punonjësi i shërbimit psiko-social, duke shtuar këtu aktivitetet vlerësuese, parandaluese dhe edukuese.⁹

Një vit më vonë, urdhëri nr.344 dt. 19.08.2013 i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës parashikon ngritjen e Njesisë së Shërbimit Psiko-social pranë Drejtorive Arsimore dhe Zyrave Arsimore. Numri i psikologëve shkollorë llogaritet mbi bazën e numrit të nxënësve dhe nivelin e shkollimit të tyre. Rregullimet ligjore të këtij urdhëri përfshihen edhe në Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar ku: *“Shërbimi psiko-social vlerëson gjendjen psiko-sociale të nxënësve me probleme të nxënësve ose sjelljes dhe në bashkëpunim me mësuesit, drejtuesit e institucioneve arsimore dhe prindërit, planifikon e realizon shërbime të përshtatshme që ndihmojnë në zhvillimin arsimor, social dhe personal të*

⁸ Ligj nr. 69/2012 Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë

⁹ Po aty: Neni 46.

nxënësit.” Ky urdhër, parashikoi për herë të parë edhe ngritjen e grupit multidisiplinar për shërbimin psiko-social pra i përbërë nga një punonjës social dhe një psikolog për një numër më të madh nxënësish.

Sipas Ligjit të Arsimit Parauniversitar 69/2012 dhe Dispozitave Normative të Arsimit parauniversitar detyrat dhe përgjegjësitë e ofruesi i shërbimit psiko-social janë si më poshtë:

- *Në bashkëpunim me mësuesit dhe prindërit, identifikon dhe vlerëson, nxënësit me probleme të sjelljes ose me vështirësi në të nxënë, dhe harton e zbaton plane individuale parandaluese ose rehabilituese për këta nxënës.*
- *Informon, nëpërmjet bisedave dhe seminareve, punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimet moshore tipike të nxënësve dhe problemet me të cilat hasen nxënësit gjatë të procesit të mësuarit.*
- *Ndihmon punonjësit arsimorë, prindërit dhe nxënësit në parandalimin e dhunës të mësuesve ndaj nxënësve, të nxënësve ndaj nxënësve etj.*
- *Ndihmon stafin mësimorë në procesin e gjithpërfshirjes i cili synon mësuesit integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të zakonshme.*
- *Harton, administron dhe interpreton teste psikologjike, pyetësorë mbi çështje të ndryshme.*
- *Plotëson dosjet individuale për rastet e nxënësve që kanë përfituar nga shërbimi psiko-social.*
- *Raporton me shkrim tek drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social çdo fakt për abuzim të nxënësve nga punonjës arsimor dhe prindër të nxënësit.*
- *Merr pjesë në kërkime/studime të parashikuara në planin vjetor të njësisë psiko-sociale etj.*

Gjithashtu, sipas Dispozitave normative supervizori i shërbimit psiko-social ka si detyrë edhe informimin, ndërgjegjësimin e stafit arsimor dhe nxënësve mbi shërbimin psiko-social dhe rëndësinë e tij.¹⁰

Në vitin 2013 Inspektoriati Shtetëror i Arsimit Parauniversitar (ISHA) boton për herë të parë

¹⁰ Dispozitat Normative të Arsimit Parauniversitar, 2013; 44, 45.

një manual të çertifikuar mbi “*Inspektimi dhe vetëvlerësimi i shërbimit psikologjik në shkollë*”. Ky udhëzues vjen si një material me tregues të matshëm dhe instrumente pune të cilët përcaktojnë elementet e domosdoshme të shërbimit psiko-socialë, duke u bazuar në një filozofi dhe metodologji bashkëkohore të inspektimit dhe vlerësimit të shërbimeve arsimore. Udhëzuesi përqëndrohet në 5 fusha themelore të inspektimit dhe vetëvlerësimit, përkatësisht:

Fusha 1: Vlerësimi

Fusha 2: Planifikimi

Fusha 3: Konsultimi dhe bashkëpunimi

Fusha 4: Këshillimi

Fusha 5: Zhvillimi profesional i psikologut shkollor.¹¹

Nga fokus grupet e zhvilluara rezultoi se ky manual nuk gjen përdorim të gjërë të ofruesit e shërbimit psiko-socialë në shkolla pasi një pjesë e tyre nuk e njohin si dokument dhe për një pjesë tjetër është i pa aplikueshëm në kushtet e institucioneve arsimore parauniversitare dhe SHPSS. Duhet theksuar se në këtë dokument nuk përfshihet shërbimi psiko-social në tërësi, pra nuk trajtohet roli i punonjësit social por vetëm ai i psikologut shkollor.

6.3 SITUATA E MBULIMIT ME SHPS NË SHQIPËRI

Aktualisht në të gjithë shqipërinë kemi 220 punonjës të shërbimit psiko-socialë si psikologë, punonjës social, sociologë dhe të tjerë jashtë profilit.. Nevojat reale të raportuara nga vetë DAR/ZA janë edhe për 58 psikologë dhe 65 punonjës social të tjerë dhe siç vihet re nga tabela janë disa DAR/ZA në të gjithë shqipërinë që nuk kanë raportuar mbi nevojat për staf psiko-social kjo si rrjedhojë edhe e mos kuptimit dhe mos zbatimit të urdhërit për ngritjen e njësisë psiko-sociale.

Vetëm 5 Drejtori Arsimore Rajonal dhe Zyra Arsimore raportojnë se kanë ngritur njësinë e shërbimit

¹¹ISHA, “Inspektimi dhe vetëvlerësimi i shërbimit psikologjik në shkollë” Tiranë, 2013

psiko-socialë përkatësisht Dibra, Mati, Elbasani, Gramshi dhe Tepelena, që nënkupton një shërbim të supervizuar me punonjës social dhe psikologë në organikën e saj. Edhe kjo duket problematike pasi nëse shikon raportimin e tyre specifik në numër dhe në ndarje profesionistësh duket se ka problem pasi mungojnë punonjësit social dhe kanë një numër shumë të vogël profesionistësh¹². Më poshtë është paraqitur tabela me të dhëna zyrtare nga MAS, në të cilën specifikohen shpërdarja dhe mbulimi me SHPSSH sipas DAR/ZA në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Tabela e mbulimit me shërbim psiko-social në të gjithë Shqipërinë

| DAR/ZA | Ngritja e SHPSH | | | Planifikuar sipas urdhërit | |
|----------------|-----------------|----|---------------------------------------|---|---|
| | | | Psikologë&Punonjës Socialë | Problematika me të cilat hasen | Psikologë Punonjës Socialë |
| Berat | Jo | | 4 Punonjës të paspecifikuar | -Nuk kanë të qartë pozicionin psikolog & Punonjës Socialë | 4 3 |
| Skrapar | jo | | 5 Psikologë 1 P.socialë | -Emërime jasht kritereve. -Mospërputhje me vëndët e punës. Ndryshime kontratash | 1 1 |
| Kuçovë | jo | | 3 Psikologë | -Nuk mbulohen të gjitha institucionet arsimore | 2 2 |
| Dibër | jo | po | 4 Punonjës të paspecifikuar | | 5 5 |
| Mat | | po | 5 Psikologë | -Mungojnë punonjësit social, 1 psikologe për 8-10 shkolla. -Vështirësi infrastrukturore për mbulimin total | 5 0 |

¹² Ministria e Arsimit dhe Sporteve, 2014

| | | | | | | |
|--------------|----|----|--|--|---|---|
| Bulqizë | jo | | 4 psikologe | | 0 | 0 |
| Elbasan | | po | 11 Punonjës të paspecifikuar | | | |
| Gramsh | | po | 5 psikologë | -Kërkohet një shtim i numrit për shkak të infrastrukturës | 2 | 1 |
| Peqin | jo | | 2 psikologe | | | |
| Librazhd | jo | | 1 psikolog me kohë të plotë 11 me orë pune | -11 psikologë me orë. -Punësim jashtë kritereve | 0 | 0 |
| Fier | jo | | 6 psikologe | -Mungesë buxheti për paga | 7 | 7 |
| Lushnje | jo | | 9 psikologë 1 P.Socialë | | | 8 |
| Mallakaster | jo | - | - | - | - | - |
| Gjirokastrë | jo | | 2 Psikologë | | 2 | 2 |
| Tepelenë | | po | 2 Psikologë 2 P.Socialë | -Shtesë për një punonjës. -Infrastruktura | | 1 |
| Përmet | jo | | - | -Shtrirja gjeografike nuk e mundëson shërbimin | 1 | 1 |
| Durrës | jo | | 14 të paspecifikuar | - | - | - |
| Krujë | jo | | 3 të paspecifikuar | - | - | - |
| Tiranë qytet | | po | 27 psikologë 12 P. socialë 1punonjës sociologji- filozofi | -Mungesa e numrit të punonjësve të miratuar. -Nevojitet shtesë kuadri -Ka punonjës jashtë profilit | 8 | 7 |

| | | | | | | |
|--------------------|----|--|--|---|---|---|
| Tiranë qark | jo | | 8 psikologe | Shërbimi nuk është ngritur sepse ka qënë i ngritur në kundërshtim me urdhërin në fjalë | - | - |
| Kamëz | jo | | 3 psikologe | - | - | - |
| Kavajë | jo | | 13 psikologë | - | - | - |
| Lezhë | jo | | 8 Psikologë | -Terreni gjeografik i qarkut të Lezhës është shumë i thyer dhe ka shkolla në distancë deri në 30 km; | - | - |
| Mirditë | jo | | 6 punonjës të paspecifikuar | -Kërkohen shtesë 2 punonjës. -Shpërndarja demografike vështirëson zbatimin e këtij shërbimi | 2 | 2 |
| Kurbin | jo | | 4 Psikologë 4 Punonjës socialë | -Punonjës social me kontratë | | |
| Shkodër | jo | | 16 punonjës të paspecifikuar | -Mungesë fondi pagash -Mungesë psikologesh | 5 | 5 |
| M.Madhe | jo | | 5 psikologe | -Shtrirja gjeografike | | 5 |
| Pukë | jo | | 3 punonjës të paspecifikuar | -Nr i pamjaftueshëm i psikologëve dhe punonjësve social. -Distanca nga shkolla në shkollë janë të mëdha dhe me një terrën tepër të thyer dhe malorë. | | 2 |
| Korçë | jo | | -2 psikologë -2 mësues sociologjie - 1 jashtë profilit | -Jashtë profilit 3 punonjës. -Njësia nuk është ngritur për çështje të mungesës së fondit të pagave | 8 | 8 |

| | | | | | | |
|-----------------|----|---|---|--|----|----|
| Kolonjë | jo | | 2 Punonjës të paspecifikuar | - | 0 | 0 |
| Pogradec | jo | | - | - | | |
| Devoll | jo | | 1 psikolog | - | 2 | 1 |
| Vlorë | jo | | - | - | - | - |
| Sarandë | jo | | 2 Psikologë 2 Punonjës socialë | -Punonjës jashtë profilit | 2 | 2 |
| | | | | | | |
| Delvinë | jo | | - | - | - | - |
| Kukës | jo | | - | - | - | - |
| Has | jo | | 2 psikologë | - | - | - |
| Tropojë | | | 1 psikologë | -Shtirija demografike kërkon më shumë psikologë dhe Punonjës Socialë | 2 | 2 |
| Total | 33 | 5 | 220(psikologë +P.socialë+punjonjës të tjerë jasht profilit) | | 58 | 65 |

Burimi: MAS

6.4 PROBLEMATIKAT DHE NEVOJAT E SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NË SHKOLLA

Shërbimi psiko-social në shkolla, tashmë prej 10-vitesh po ofrohet në një pjesë të shkollave të vëndit kryesisht i fokusuar në zonat urbane dhe më pak në ato rurale. Nga të dhënat e deritanishme rezulton se ky

shërbim ende vazhdon të përballet me problematika të cilat lidhen kryesisht me infrastrukturën, mënyrën e organizimit, nivelin e profesionalizmit, mosfunksionimin e sistemit të referimit dhe pengesat ligjore etj.

6.4.1 Infrastruktura

Sipas Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve problematikat me të cilat haset shërbimi psiko-social janë të shumta por më thelbësori është mosngritja e këtij shërbimi nga shumica e DAR/ZA-ve dhe shtrirja e tij. Ende nuk është e qartë shpërndarja apo shtrirja e shërbimit sipas Urdhrit 344 i MAS për ngritjen e njësisë psiko-sociale në çdo DAR/ZA, kjo për shkak se shërbimi ose nuk është ngritur ose se ka qenë i ngritur në kundërshtim me urdhrin në fjalë.¹³

Nuk mbulohen të gjitha institucionet arsimore me shërbim psiko-social dhe kjo shpesh për shkak të:

- Shtrirja gjeografike nuk mundëson shpërndarjen e shërbimit në të gjithë territorin;
- Shpërndarja demografike vështirëson zbatimin urdhërit dhe mbulimin e këtij numri;
- Distancat nga shkolla në shkollë janë të mëdha dhe me një terren tepër të thyer dhe malor;
14
- DAR/ZA raportojnë se mungojnë punonjës socialë në zonat e tyre dhe si rrjedhojë edhe në shërbim;
- DAR/ZA kanë probleme të mbulimit të nevojave të tyre me personel në përgjithësi, ku përfshihet si pasojë edhe shërbimi, për arsye të burimeve të kufizuara buxhetore;
- Ka probleme të emërimeve jashtë kriterëve, ku konstatohen mospërputhje me vendet e punës, pra në DAR/ZA të ndryshëm shërbimi ofrohet nga punonjës jashtë profilit.

¹³ Takim mbi shërbimin psiko-social, MAS ,21 Korrik 2014

¹⁴ Ministria e Arsimit dhe Sporteve, 2014

Një problem tjetër lidhur me infrastrukturën qëndron në faktin se në shumicën e shkollave në të cilat ofrohet shërbimi psiko-social, mungojnë ambjentet e punës apo një zyrë e përshtatshme për të zhvilluar aktivitetet e punës së përditshme të punonjësve. Këtu duhet përmendur se PSHPS¹⁵ kanë zyrë vetëm në shkollën në të cilën marin emërimin, ndërsa në shkollat e tjera të cilat mbulohen prej tyre ata nuk e disponojnë një të tillë. Gjithashtu duhet shtuar se ka edhe raste ku, PSHPS disponojnë një ambjent pune të cilin e ndajnë me infermierin, zv/drejtorin apo pastruesin e shkollës. Kjo situatë ndikon dukshëm në cilësinë e këtij shërbimi, i cili në kushtet e tanishme është i fokusuar kryesisht tek konsultimi, këshillimi dhe ndërgjegjësimi.

Mungesa e një buxheti specifik të destinuar dhe parashikuar për shpenzime kancelarike apo aktiviteteve të tjera të programuara nga punonjësit e SHPSSH, ndikon direkt në mosrealizimin e aktiviteteve të tilla si si testime, vlerësime, përgatitje dhe ruajtje e dosjeve të rasteve, aktivitete sensibilizuese/ndërgjegjësuese, etj., apo zhvillimin në disa raste të tyre me shpenzimet e vetë punonjësit.

Veprimtaria ditore, javore, mujore e semestrale e një PSHPS nuk është e standartizuar dhe e rregulluar për të gjithë shërbimin. Megjithatë ekzistojnë plane pune, zakonisht ato nuk gjejnë zbatim, ndaj veprimtaria e PSHPS duket si veprimtari e lirë. Ajo pritet të jetë e përcaktuar që të mund të supervizohet dhe dokumentohet. Një shembull i rëndësishëm në këtë drejtim është pamundësia e deritanishme për planifikimin dhe programimin e një hapësire kohore të përshtatshme për realizimin e orëve sensibilizuese/ndërgjegjësuese apo punës individuale me nxënësit. Aktualisht veprimtaria e tij zhvillohet gjatë pushimeve të shkurtra midis orëve ose pas mësimit. Askund nuk është përshkruar se në çfarë kohe do ta zhvillojë PSHPS punën e vet me nxënësit, mësuesit, prindërit etj.

PSHPS raportojnë gjithashtu që *“shpesh bëjnë rolin e “zëvendësuesit”, pra detyrohen nga drejtuesit e shkollave që në rastet kur mungojnë mësuesit, ti zëvendësojnë në orët mësimore, gjë që ndikon dukshëm në filozofinë dhe cilësinë e këtij shërbimi.”*¹⁶

¹⁵ Punonjes i shërbimit psiko-social sipas Ligjit nr. 69/2012, date 21.06.2012, *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*

¹⁶ Fokus grupe me PSHPSSH

Në Ligjin nr. 69/2012, date 21.06.2012, “Per sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet që për një numër 2800-3500 nxënësish në shkollat e arsimit të mesëm, të vihet në dispozicion një psikolog dhe një punonjës social. Aktualisht një numër i tillë mbulohet vetëm nga një profesionist (punonjës social ose psikolog), i cili për shkak të këtij numri të lartë nxënësish mbulon njëkohësisht disa institucione arsimore të niveleve të ndryshme, si kopshte, shkolla 9-vjeçare dhe të mesme. Si rrjedhojë në këto institucione nuk ka një prezencë të përditshme të PSHPS gjë që ndikon në mosndjekjen e e vazhdueshme të rasteve problematike, të cilët mund të përkeqësohen apo të zgjidhen në mënyrë jo profesionale. Kjo nuk i lejon gjithashtu këta profesionistë të fokusohen apo të zhvillohen profesionalisht në problematikat e të paktën një grupmoshe. Gjithashtu, për shkak të numrit të lartë të nxënësve bëhet i pamundur kontaktimi, identifikimi apo trajtimi të gjithë rasteve problematike në mënyrë profesionale.

Mungesa e një statusi ligjor të rregulluar për profesionet e punonjësit social dhe psikologut ka bërë që ofruesit e shërbimit psiko-social në shkolla, të kenë atributet e një mësuesi si në rekrutime ashtu edhe në termat e referencës. Kjo vjen dhe si rezultat i mungesës së përshkrimeve të punës për të dy pozicionet, gjë që ndikon në difuzionin dhe konfuzionin e roleve apo paqartësinë që krijohet si tek vetë PSHPS ashtu dhe aktorët e tjerë me të cilët bashkëpunon.

Standartizimi i dokumentacionit vazhdon të jetë një tjetër problem për këtë shërbim. Mungojnë testet dhe formatet e vlerësimit të standartizuara, si dhe baza ligjore mbi dokumentacionin që PSHPS duhet të përgatisin, përdorin dhe ruajnë në mënyrë të unifikuar për të gjithë ofruesit e këtij shërbimi. Një grup i punonjëseve të SHPSSH në Tiranë me eksperiencë që në fillimet e shërbimit, në iniciativën e tyre personale kanë përshtatur disa formate vlerësimi të cilat përdoren nga një pjesë e tyre, por kjo nuk përbën një praktikë zyrtare dhe të detyruar për të gjithë shërbimin. Akoma ofruesit e shërbimit nuk kanë në përdorim protokolle të veçanta pune për trajtimin e rasteve të vështira apo problematikave të veçanta, si ato të formave të ndryshme të abuzimit të fëmijëve, abuzimit me substanca, etj. Vlen të

theksohet se në fushën e trajtimit të fëmijëve me nevoja të veçanta, në kuadër të gjithëpërfshirjes së tyre në sistemin arsimor parauniversitar ekzistojnë planet edukative individuale (PEI) të standartizuar në përdorim të PSHPSSH.

6.4.2 Supervizimi/Raportimi

Sistemi i raportimeve të PSHPS ende nuk është i qartë: ata kanë detyrimin e një raportimi të dyfishtë, tek drejtuesit e institucioneve ku punojnë si dhe tek personi i ngarkuar nga DAR për të supervizuar punën e tyre. Në realitet kjo mënyrë raportimi duket se nuk ka funksionuar siç duhet, pasi në këndvështrimin e PSHPS, drejtuesit e shkollave jo gjithmonë janë të qartë dhe të aftë për të kuptuar dhe monitoruar Shërbimin psiko-social që ofrohet në shkollat e tyre dhe rolet e detyrat e punonjësve të tij. Nga ana tjetër për personat përgjegjës në DAR, supervizimi i shërbimit psiko-social përbën një ndër detyrat që ata kryejnë, pra ata nuk merren specifikisht vetëm me supervizimin, dhe jo gjithmonë këta persona janë të specializuar në këtë fushë.

Në Tiranë ka disa nisma *intervizioni*, ku vetë PSHPS organizohen dhe diskutojnë mbi rastet e vështira që hasin në punën e tyre, por kjo nuk mjafton dhe nuk është e shtrirë në qytetet e tjera.¹⁷ PSHPS pohojnë vetë se nuk janë të supervizuar profesionalisht, nuk janë intervistuar apo anketuar dhe se për ta nuk janë realizuar ndonjëherë vlerësime nga të tretët. Ata e kanë raportuar punën e tyre sipas dokumentave që iu janë kërkuar dhe pse nuk kanë marrë një feedback të mëtejshëm.¹⁸

6.4.3 Sistemi i Referimit

Modeli që aplikojnë sot PSHPS në shkolla është ai i një pune individuale. Pra çdo PSHPS ka shkollat e veta, identifikon vetë rastet apo që i raportohen nga aktorë të tjerë të shkollës dhe përpiqet

¹⁷ Vlerësimi i nevojave të këshilluesve shkollorë mbi DHBGJ, SHKPS, 2013

¹⁸ Po aty

që të merret me ta. Ky konceptim krejt i izoluar individual i punës nuk zgjidh dhe nuk ndihmon në zgjidhjen e një numri çështjesh që mund të trajtohen në mënyrë multidisiplinare në kushtet ku modeli multidisiplinar nuk aplikohet aktualisht, edhe pse ne urdhrin Nr. 344, dt. 19.08.2013, “*Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social*”, shërbimi duhet të përfshijë të dy figurat profesionale, si punonjësin social ashtu edhe psikologun për të njëjtin numër të caktuar nxënësish). PSHPS e intervistuar vënë në dukje se kanë bërë përpjekje për t’u konsultuar me njëri tjetrin kur kanë hasur vështirësi të veçanta, por kjo është kryer si një iniciativë individuale dhe nuk është parë si model ndërhyrjeje.¹⁹

PSHPS nuk kanë informacion mbi shërbimet që ekzistojnë në territorin e tyre për të referuar raste të vështira të cilat kanë nevojë për një trajtim më të specializuar dhe kompleks. Në kushtet kur sistemi i mbrojtjes shoqërore për kategori të veçanta të fëmijëve dhe adoleshentëve ende nuk është i konsoliduar dhe i shpërndarë në të gjithë vendin, dhe ku mungojnë bashkëpunimet zyrtare me OJF-të, sistemi i referimit mbetet jo funksional. Edhe në rastet kur këto shërbime ekzistojnë, përvoja e tyre jo pozitive, nxit izolimin dhe trajtimin joadekuat për këto raste.

6.5 REKOMANDIME MBI PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NË SHKOLLA

6.5.1. Rekomandime për vendimmarrësit

Të rishikohet i udhërit nr 344 i ministrit, lidhur me problematikën e raportit PSHPS/nr. nxënësish, duke adresuar specifikat e shërbimit në zonat rurale ku shkollat janë larg njëra tjetrës dhe me një numër të vogël nxënësish.

Të krijohet një grup pune në nivel profesionistesh për të standartizuar shërbimin në të gjithë Shqipërinë me fokus të veçantë në rregulloren e shërbimit, përshkrimet e punës, manualin e shërbimit, sitemin e monitorimit dhe vlerësimit, sistemin e raportimit, sitemin e referimit, teste dhe formate

¹⁹ Po aty

vlerësimi të rasteve të standartizuara, kodin e etikës dhe protokollin e punës.

Të rritet numri i punonjësve të SHPS në strukturat ekzistuese dhe të shtrihet ky shërbim në të gjithë territorin e vendit, gradualisht duke filluar me 20 % -30% rritje të numrit çdo vit (sipas mundësive buxhetore të MAS) dhe njëkohësisht duke bërë të mundur zbatimin e qasjes së ekipit multidisiplinar, siç dhe është përcaktuar në ligjin për arsimin parauniversitar.

Të shikohet ndarja në shkolla e profesionisteve, ku një profesionist të mbulojë vetëm një grupmoshë, pasi në këtë mënyre do të rritej cilësia e shërbimit dhe niveli i profesionalitetit.

Të reformohet procesi i punësimit të ofruesve të shërbimit psiko-social duke iu përmbajtur parimit të mbrojtjes së të drejtave të përfituesve për marrë shërbim psiko-social nga profesinistë të arsimit përkatës universitar e pasuniversitar, duke siguruar një shërbim cilësor për të gjithë.

Qartësimi i formave të bashkëpunimit dhe mbështetjes që duhet t'i ofrohet shkollës “nga jashtë” , nëpërmjet vendosjes së marrëveshjeve zyrtare funksionale të bashkëpunimit me autoritetet lokale, DAR, organet e policisë, OJF-të, shërbimet sociale, shëndetësore, ligjore, dhe ato komunitare.

Të ristrukturohet nga MAS forma e supervizimit dhe kontrollit të SHPS për ta bërë më të matshëm dhe cilësor veprimtarinë e përditshme të punonjësit të shërbimit psiko-social (punonjës social dhe psikolog).

Të përfshihen në aktivitetin e supervizimit të PSHPS profesionistë të specializuar fushave përkatëse, si rregull senior në profesion, apo specialistë të trajnuar për të supervizuar, të emëruar si të tillë dhe me përshkrim të qartë pune.

Të qartësohet roli i punonjësve të shërbimit psiko-social në shkolla, nëpërmjet urdhërave konkret për drejtoritë e shkollave, pasi ka shumë mësues dhe drejtues shkollash të cilët nuk e njohin dhe nuk duan ta njohin rolin e këtij specialisti në shkollë.

Të zhvillohen trajnime për drejtuesit dhe mësuesit e institucioneve arsimore për rolin dhe

funksionin e shërbimit dhe punonjësve të tij.

Të institucionalizohet sistemi i trajnimit të vazhdueshëm për punonjësit të shërbimit psiko-social duke aplikuar një sistem çertifikimi dhe akreditimi.

Të zbatohet ligji për arsimin parauniversitar dhe Urdhri 344 për SHPSSH në shtimin arsimor privat të të gjithë niveleve, çerdhe, kopshte dhe shkolla.

Të plotësohet dhe rishikohet lista dhe përmbajtja e rregulloreve të SHPSSH duke përfshirë dokumentacionin për funksionimin e SHPS, të tilla si: plani i punës në ekip, planet individuale, raportet periodike të të punës, formatet e vlerësimit për punën me rastet individuale dhe me grupet, raportet të fushave apo problematikave të tjera specifike, procesverbalet/ditaret e takimeve të mbajtura, procedurat e pranimit të rasteve, sistemin e referimit, procedurat e marrjes së lejes së prindit, etj., në bashkëpunim me të gjitha palët e interesuara.

Të ndërtohen instrumentet dhe formularët e nevojshëm të standartizuar për pranimin e rasteve, raportimin, referimin dhe dokumentimin e punës së SHPS.

Të ndihmohen SHPS për t'u organizuar në një bashkësi profesionale që punon për interesat e saj duke filluar me hartimin e kodit të etikës në SHPS, me negocimin për kushtet e punës, etj.

Të vihen në dispozicion të SHPSSH mjedise të posaçme dhe të përshtatshme në çdo institucion, duke përfshirë edhe materiale kancelarike, pajisje kompjuterike dhe shërbim interneti.

6.5.2.Rekomandime për ofruesit e shërbimit psiko-social në shkolla

Të hartojnë dhe shpërndajnë materiale udhëzuese informative, fletë-palosje për prindërit, mësuesit, nxënësit për rolet dhe shërbimet që ofron shërbimi psiko-social në shkolla.

Të zhvillojnë vlerësime periodike, të paktën nga një në semestër në formën e pyetsorëve, intervistave, fokus grupeve, etj., me qëllim identifikimin e nevojave dhe problematikave të të nxënësve dhe shkollës në tërësi.

Të ndërtojnë plane pune individuale për rastet me të cilat punojnë, konkrete dhe realiste, me objektiva dhe aktivitete për arritjen e tyre në kohë.

Të fokusohen dhe të aplikojnë metodën e menaxhimit të rastit në punën e tyre, si një metodë efikase në trajtimin efektiv dhe profesional të rasteveproblematike me të cilat përballen në punën e përditëshme.

Të organizojnë në mënyrë të vazhdueshme aktivitete informuese, ndërgjegjësuere dhe parandaluese në bashkëpunim me institucione dhe organizata të ndryshme, me nxënës, mësues dhe prindër sipas programeve vjetore.

Të njohin dhe listojnë të gjithë shërbimet dhe ofruesit e tyre në komunitetin ku ndodhet institucioni arsimor dhe të bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme.

Të punojnë për të forcuar bashkëpunimin me aktorët dhe palët e interesuara jashtë shkollës, si OJF, agjensi vendore, shërbime sociale dhe ligjore, qendra të kujdesit të shëndetit publik, etj.

Të punojë vazhdimisht për të siguruar mbështetje dhe bashkëpunim me drejtuesit e institucioneve arsimore, stafin pedagogjik dhe prindërit, për një punë cilësore dhe gjithpërfshirëse.

Të njohin dhe zbatojnë të gjitha parimet e kodit të etikës së punës në profesionin përkatës në të gjithë proceset e saj si në vlerësim, ndërhyrje, parandalim, këshillim, etj.

Të kujdeset në mënyrë të vazhdueshme për të ruajtur higjienën e tyre mendore, minimizojë stresin dhe për të shmangur konsumimin profesional në punë.

Të marrin pjesë në aktivitetet e supervizionit dhe intervizionit që do të organizojë SHPSSH ne nivel DAR/ZA.

Të anëtarësohen në shoqatat kombëtare dhe ndërkombëtare të profesionistëve, si dhe të marrin pjesë në konferenca shkencore ku trajtohen problematika dhe çështje të ndryshme me të cilat ndeshen gjatë punës së tyre.

Të marrin pjesë në programe të trajnimit të vazhdueshëm të akredituar për rritjen e tyre profesionale.

REFERENCA

Ligjit nr. 69/2012, date 21.06.2012, *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*

Urdhëri Nr.344 datë 19.08.2013 *“Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social”*

Urdhër Nr.321, datë 11.10.2004, Për eksperimentimin e shërbimit psikologjik në sistemin arsimor parauniversitar.

Udhëzim Nr.30, datë 11.10.2004, Për zbatimin e urdhërit NR.321, datë 11.10. 2004 të ministrit për eksperimentimin e shërbimit psikologjik në sistemin arsimor parauniversitar për vitet shkollore 2004-2005 dhe 2005-2006.

Studim: *“Vlersimi i Këshilluesve Shkollorë mbi DHBGJ”*, SHKPS, 2013

Studim: *“Vlersimi i shërbimit psikologjik shkollorë”* UNICEF,2007

ISHA, *“Inspektimi dhe vetëvlerësimi i shërbimit psikologjik në shkollë”* Tiranë, 2013

School Social Work Worldwide, Huxtable M., Blyth E., (Eds), NASW PRESS, 2002.

Jimerson, S., Oakland, T., Farrell,P.: *“The handbook of international school psychology”*, Sage Publications, London, 2007..

Nano, V. (2003) *“Trajtimi i fëmijëve me vështirësi shkollore, sfidë për përmirësimin e shkollës”* në Cikli Fillor 5/2003. ISP.

Tahsini I., *“Puna sociale në shkolla”*, Revista pedagogjike, nr.1, Tiranë, 2007.